

**Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete**

**Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor**

**PËRDORIMI I PARABURGIMIT NË PROCEDURAT  
PENALE NË KOSOVË:  
SHQYRTIM DHE ANALIZË GJITHËPËRFSHIRËSE E BRENGAVE TË  
MBETURA**

**– Pjesa I –**

**Nëntor, 2009**

## Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE .....	1
I. HYRJE.....	2
II. KORNIZA LIGJORE.....	2
III. KËRKESAT PËR PARABURGIM DHE SEANCAT E DËGJIMIT .....	4
A. Koha e mbajtjes së seancave të dëgjimit.....	4
B. Kallëzimet penale të vonuara .....	7
C. Kërkesat e paarsyetuara të prokurorëve për paraburgim.....	8
D. Kryerje e dobët e detyrave nga ana e avokatëve mbrojtës .....	10
E. Mungesa e seancës së dëgjimit për caktimin e paraburgimit në disa raste .....	12
IV. ARSYETIMI I AKTVENDIMEVE PËR PARABURGIM .....	15
V. ZBATIMI I GABUESHËM I PARABURGIMIT NË PROCEDURËN E..... SHKURTËR .....	16
VI. KOHËZGJATJA E PARABURGIMIT NË PRITJE TË GJYKIMIT .....	18
VII. SHKELJET TJERA NË LIDHJE ME PARABURGIMIN.....	21
VIII. SITUATA NË KOMUNAT VERIORE TË RAJONIT TË MITROVICËS.....	22
IX. PËRFUNDIM .....	24
X. REKOMANDIMET.....	25

## PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport bazohet në monitorimin dhe analizimin e drejtpërdrejt të 125 lëndëve të cilat përfshijnë procedura të paraburgimit në gjykatat komunale dhe të qarkut në Kosovë gjatë periudhës kohore prej nëntë muajve.<sup>1</sup> Raporti gjithashtu i analizon disa lëndë dhe situata që kanë ndodhur jashtë periudhës për të cilën raportohet, për aq sa ato përbëjnë çështje të rëndësishme të ligjit apo brenga të të drejtave të njeriut që janë veçanërisht serioze.

Në përgjithësi, Misioni i OSBE-së në Kosovë (OSBE) gjeti që, ndonëse ka pasur disa përmirësime, procedurat e paraburgimit në Kosovë ende nuk i përmbushin standardet ndërkombëtare.

Ligji i zbatueshëm në Kosovë është modern, në përputhje me të drejtat e njeriut dhe, me disa përjashtime<sup>2</sup>, i qartë. Megjithatë, mbeten probleme përkitazi me mënyrën se si zbatohet ligji nga akterët e ndryshëm institucional të cilët luajnë rol në paraburgime, përkatësisht policia, prokurorët, gjyqtarët dhe avokatët mbrojtës. Zbatimi jo i duhur i ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut rezulton në shkelje të vazhdueshme të së drejtës së të pandehurit për liri, dhe të gjithë akterët e përfshirë e ndajnë përgjegjësinë për këto shkelje, më shumë apo më pak.

OSBE-ja gjeti që policët ndonjëherë dështojnë t'ua dorëzojnë pa vonesë kallëzimet penale prokurorëve, duke u lënë këtyre të fundit pak kohë për të hartuar kërkesa të arsyetuara si duhet për paraburgim. Prokurorët shpesh dështojnë që t'i mbështesin kërkesat e tyre për paraburgim me arsye të mjaftueshme, dhe nganjëherë duket se mbështeten tepër në paraburgime, madje edhe në situatat kur masat tjera më pak kufizuese (siç janë arresti shtëpiak, paraqitja në stacion policor, dorëzania, etj) duken të mjaftueshme për një zhvillim të duhur të hetimeve. Gjykatat shpeshherë vendosin për paraburgim edhe kur faktet e lëndës ndoshta nuk e arsyetojnë masën e paraburgimit dhe shumica e vendimeve për paraburgim përmbajnë arsyetim abstrakt dhe të pamjaftueshëm. Avokatët mbrojtës shpeshherë dështojnë që ta kundërshtojnë në mënyrë efikase nevojën për paraburgim, duke mos e mbrojtur sa duhet të drejtën e klientëve të tyre për liri.

Andaj, edhe pse është mjaft mirë e mbrojtur në të drejtën e zbatueshme ndërkombëtare dhe vendore, e drejta për liri ende rrezikohet në Kosovë nga zbatimi i gabueshëm i ligjit. Akterët institucionalë të përfshirë në procedurat e paraburgimit, në veçanti prokurorët publikë dhe gjyqtarët, duhet ta mbrojnë më me vigjilencë të drejtën për liri, dhe duhet të zbatojnë paraburgimin vetëm atëherë kur është më se e nevojshme dhe në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit.

---

<sup>1</sup> Periudha e raportimit ka qenë 1 janar – 30 shtator 2008. Monitorimi ka vazhduar më tej, megjithëse me intensitet më të ulët përtej periudhës së raportimit, në bazë të mandatit të OSBE-së për të monitoruar procedurat gjyqësore.

<sup>2</sup> Një përjashtim i tillë është mospërputhja e nenit 14 (2) të Kodi të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet pasuese (KPPPK) – i cili parasheh që personi i arrestuar dërgohet para gjyqtarit brenda 72 orëve – me nenin 212 (4) KPPPK (i ndryshuar më 22 dhjetor 2008) – i cili kërkon që personi i arrestuar dërgohet para një gjyqtari brenda 48 orëve, ose përndryshe lirohet.

## I. HYRJE

Që nga viti 2000, OSBE-ja i ka kushtuar shumë vëmendje mënyrës se si zbatohet paraburgimi gjatë procedurave penale në Kosovë. Paraburgimi ka qenë pikë përqendrimi e aktiviteteve monitoruese të OSBE-së të të drejtave të njeriut si për shkak të një rëndësie të posaçme të së drejtës së personit për liri, ashtu edhe për shkak se organet e ndryshme monitoruese ndërkombëtare dëshmojnë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme që, fatkeqësisht, shkeljet e kësaj të drejte themelore mbeten një dukuri e përhapur në tërë botën.<sup>3</sup>

OSBE-ja ka raportuar vazhdimisht për brenga të ndryshme rreth zbatimit të paraburgimit në Kosovë.<sup>4</sup> Në raportin e saj për *Shqyrtimin e Sistemit të Drejtësisë Penale* të vitit 2000, OSBE-ja gjeti që gjykatat në Kosovë kishin dështuar që t'i arsyetojnë në mënyrë të duhur vendimet fillestare për paraburgim dhe të marrin parasysh zbatimin e masave tjera alternative në vend të paraburgimit; që kishte një mungesë të njëtrajshmërisë në përcaktimin e kohës kur fillon vazhdimi i paraburgimit; dhe që gjykatat kishin dështuar që të tregojnë kujdes të duhur në trajtimin e çështjeve të paraburgimit, dhe me sa duket nuk ishin të vetëdijshme sa duhet se si duheshin trajtuar kërkesat *habeas corpus*.<sup>5</sup>

Ky raport vlerëson deri në çfarë mase janë adresuar problemet dhe mangësitë e raportuara më parë nga hisedarët gjegjës. Raporti i shqyrton standardet<sup>6</sup> e zbatueshme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe ligjin vendor të Kosovës që rregullon aplikimin e paraburgimit në procedura penale. Në bazë të kësaj kornizë, raporti vlerëson mënyrën në të cilën paraburgimi aplikohet në praktikë nga gjykatat. Raporti gjen që, ndonëse është arritur një progres gjatë viteve të kaluara, fatkeqësisht mbeten shumë mangësi në mënyrën e zbatimit të paraburgimit gjatë procedurave penale në Kosovë.

## II. KORNIZA LIGJORE

Të gjitha paraburgimet e cenojnë një të drejtë themelore të njeriut: të drejtën për liri dhe siguri të personit.<sup>7</sup> Liria personale është një gjendje qenësore që duhet ta gëzojë çdo person në përgjithësi, dhe çfarëdo kufizimi i lirisë do të duhej të ishte gjithmonë përjashtim, i arsyetuar në mënyrë objektive, dhe sa më i shkurtër që është e mundur.

<sup>3</sup> Këshilli për të Drejtat e Njeriut i OKB-së, *Raporti i Grupit Punues për Vendimet Arbitrare*, A/HRC/10/21 (16 shkurt 2009), paragrafi 45.

<sup>4</sup> Shih, për shembull, Raportin e SMSL-së në Kosovë. Shqyrtimi i Sistemit të Drejtësisë Penale (prill 2003– tetor 2004). Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi.

<sup>5</sup> Ibidem.

<sup>6</sup> E drejta ndërkombëtare e përdorur si referencë për analizën ligjore në këtë raport është KEDNJ-ja, në veçanti neni 5 për të drejtën në liri dhe siguri, dhe e drejta lëndore e GjEDNJ-së që e interpreton këtë të drejtë. KEDNJ-ja u zgjodh si referencë për shkak se është treguar si sistemi më i përparuar i të drejtave të njeriut në botë, por gjithashtu për shkak se është drejtpërdrejtë i zbatueshëm në Kosovë (shih Rregulloren e UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e Zbatueshëm në Kosovë, neni 1.3. (b); shih, Rregulloren e UNMIK-ut 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjen e Përkohshme në Kosovë, neni 3.2(b); shih gjithashtu nenet 22(2) dhe 53 të Kushtetutës ).

<sup>7</sup> Neni 9(1), Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike; neni 5(1), Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; Neni 12(1) KPPPK. Neni 29 i Kushtetutës.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) ka theksuar vazhdimisht që e drejta për liri, krahas së drejtës për jetë, liri nga tortura dhe keqtrajtimi, dhe të drejtës për liri të lëvizjes, është “në rendin e parë të drejtave themelore të njeriut që mbrojnë sigurinë fizike të një individi [...] dhe si e tillë ka rëndësi të jashtëzakonshme.”<sup>8</sup>

Çfarëdo privimi i lirisë mund të ndikojë gjithashtu në gëzimin e të drejtave të tjera të një personi, si në të drejtën për jetë private, për liri të tubimit, apo lëvizje të lirë dhe gjithashtu mund ta vë individin në pozitë të cenueshme dhe në rrezik të keqtrajtimit.<sup>9</sup> Prandaj, organet e rendit dhe ato gjyqësore duhet gjithmonë t’i peshojnë si duhet arsyet në çdo rast ku ato mendojnë ta caktojnë paraburgimin. Për më tepër, nevoja për paraburgim duhet të balancohet gjithmonë kundrejt të drejtës themelore të personit për t’u konsideruar si i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia e tij.<sup>10</sup>

Duke e pasqyruar rëndësinë e jashtëzakonshme të së drejtës për liri, konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e drejta e procedurës penale në shoqëritë demokratike vendosin një sistem të garancive të fuqishme për të gjithë personat e privuar nga kjo e drejtë themelore. Policët, prokurorët publikë dhe gjyqtarët duhet t’i zbatojnë me kujdes këto garanci procedurale në praktikë.

Qëllimi i përgjithshëm i kornizës normative që rregullon përdorimin e paraburgimit gjatë procedurave penale është ta mbrojë të drejtën për liri dhe të sigurojë që askujt të mos i hiqet liria në mënyrë arbitrare.<sup>11</sup>

Në Kosovë, korniza ligjore ku përmbahet e drejta për liri përbëhet nga standarde ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejt, si dhe nga legjislacioni vendor përkatës. Në nivelin ndërkombëtar, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (PNDPC) thekson që çdo privim lirie duhet të bëhet duke u bazuar në baza dhe në pajtim me procedurën që përcaktohet me të drejtën vendore (parimi i ligjshmërisë).<sup>12</sup> Në mënyrë të ngjashme, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (KEDNj) kërkon që privimi i lirisë të jetë në pajtim me ligjin, dhe vetëm për qëllimet e renditura aty.<sup>13</sup> Ligji vendor i procedurës penale i zbatueshëm në Kosovë përcakton në mënyrë të ngjashme që “Askujt nuk mund t’i hiqet liria, përpos rasteve dhe sipas procedurave të përcaktuara me ligj.”<sup>14</sup> Paraburgimi mund të urdhërohet brenda 48 orëve nga koha e arrestimit,<sup>15</sup> vetëm pasi të jetë mbajtur seanca e dëgjimit në prani të të pandehurit dhe mbrojtësit të tij,<sup>16</sup> dhe vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet nga testi pasues tre pjesësh:

<sup>8</sup> Shih *Musuc kundër Moldavisë*, paragrafi 37 i Aktgjykimit të GjEDNj-së i 6 nëntorit 2007.

<sup>9</sup> Shih Monica Macovei, E drejta e personit për liri dhe siguri. Udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Këshilli i Evropës, Doracaku i të Drejtave të Njeriut (nr. 5), 2002), faqe 6.

<sup>10</sup> Neni 14(2) PNDPC; Neni 6(2) KEDNj; Neni 3(1) KPPK.

<sup>11</sup> Shih *Saadi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 66 i Aktgjykimit të GjEDNj-së i 29 janarit 2008.

<sup>12</sup> Neni 9(1) PNDPC.

<sup>13</sup> Neni 5(1) KEDNj.

<sup>14</sup> Neni 13(1) KPPK.

<sup>15</sup> Neni 212(4) KPPK. Shih gjithashtu neni 29(2) i Kushtetutës.

<sup>16</sup> Neni 282 KPPK.

- Ekziston dyshim i bazuar që personi ka kryer një vepër penale;
- Ekziston rreziku që personi i dyshuar (i) të arratiset ose që identiteti i tij/saj nuk mund të vërtetohet; (ii) do të asgjësojë ose falsifikojë provat, ndikojë tek dëshmitarët apo palët e dëmtuara ose bashkëpjesëmarrësit (iii) do të përsëris veprën penale; dhe
- Masat alternative ndaj paraburgimit të parapara në kod janë të pamjaftueshme për të siguruar praninë e të akuzuarit, të parandalojë përsëritjen e veprës penale dhe të sigurojë zbatimin e suksesshëm të procedurës penale.<sup>17</sup>

Një garanci tjetër, e rëndësisë së veçantë, është se vendimet për paraburgim duhet të përmbajnë arsytim të hollësishëm përse është i nevojshëm privimi i lirisë në rrethana specifike të lëndës.<sup>18</sup> Në fund, ligji gjithashtu inkorporon parimin “jo më gjatë se që është e nevojshme” duke përcaktuar që “[ç]do heqje lirie, e sidomos paraburgimi në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.”<sup>19</sup> Të gjitha këto garanci që i përmban ligji vendor i Kosovës, pasqyrojnë standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtën për liri dhe siguri të personit.

Vlen të përmendët që masa e arrestit shtëpiak, ndonëse e ndryshme në aspektin teknik nga paraburgimi, duhet të zbatohet duke i respektuar të njëjtat standarde procedurale. Ky rregull i përgjithshëm pasqyrohet si në ligjin vendor, ashtu edhe atë ndërkombëtar.<sup>20</sup> Masat tjera, si alternativë ndaj paraburgimit, rregullohen me procedura që janë më pak rigoroze.

Për t’u siguruar që e drejta për liri mbrohet në mënyrë efikase në Kosovë, në pajtim të plotë me legjislacionin ndërkombëtar dhe vendor, dispozitat ligjore që e rregullojnë zbatimin e paraburgimit gjatë procedurave penale duhet të respektohen me përpikëri në të gjitha rastet.

### III. KËRKESAT PËR PARABURGIM DHE SEANCAT E DËGJIMIT

#### A. Koha e mbajtjes së seancave të dëgjimit

Sipas KEDNj-së, “çdo person i arrestuar apo i paraburgosur [...] sillet shpejtë para gjyqtarit.”<sup>21</sup> Konventa Evropiane nuk e definon termin “shpejtë”, dhe ia lë caktimin e afateve specifike kohore ligjit vendor.<sup>22</sup>

<sup>17</sup> Neni 281(1), pikat (1-3), KPPPK.

<sup>18</sup> Neni 283 (1) KPPPK.

<sup>19</sup> Neni 5(3) KPPPK.

<sup>20</sup> Për kornizën ligjore të Kosovës, shih nenet 278(7), 281(1) dhe 283(1), KPPPK, në lidhje me njëri-tjetrin. Për ligjin ndërkombëtar, shih *Vachev kundër Bulgarisë*, paragrafi 63 i Aktgjykimit të GjEDNj-së, që thotë se arrestet shtëpiake përbëjnë privim lirie dhe prandaj do të duhej të zbatohen në pajtim me të gjitha garancitë që i përmban neni 5 i KEDNj-së.

<sup>21</sup> Neni 5(3) KEDNj.

<sup>22</sup> Sipas GjEDNj-së, megjithatë, arresti policor për më gjatë se katër ditë do ta shkelte në parim garancinë “të sillet shpejtë para gjyqtarit” nga neni 5 (3) i KEDNj-së; disa përjashtime janë të pranueshme në rrethana të jashtëzakonshme, p.sh. kur është teknikisht e pamundur që një i arrestuar të çohet para një

Deri në dhjetor 2008, KPPPK-ja parashihte që çdo person i arrestuar nga policia duhet të dërgohet para gjyqtarit të procedurës paraprake brenda 72 orëve, ose të lirohet. Pas disa ndryshimeve të bëra në legjislacion,<sup>23</sup> tani Kodi siguron që ndalimi i një personi të arrestuar nga policia “nuk mund t’i kalojë 48 orë nga koha e arrestimit”. Pas kalimit të këtij afati, policia e liron të ndaluarin, përveç rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin.”<sup>24</sup> Ndryshimi legjislativ që shkurtoi periudhën maksimale kohore të ndalimit policor nga 72 në 48 orë është i mirëseardhur në kuptim të të drejtave të njeriut, meqë zvogëlon periudhën kohore sa një i pandehur mund të mbahet në ndalim policor, pa një mbikëqyrje gjyqësore të gjendjes së tij/saj.

OSBE-ja bëri monitorim të përqendruar në seancat e dëgjimit për paraburgim në nëntë muajt e parë të vitit 2008, kur rregulli i 72 orëve ishte ende në fuqi dhe për këtë arsye u analizua respektimi i saj. Monitorimi zbuloi që në shumicën e lëndëve (mbi 95%),<sup>25</sup> paraburgimi u urdhërua brenda këtij afati të paraparë ligjor. Ky është një rezultat shumë i kënaqshëm, dhe policia, prokurorët dhe gjyqtarët e procedurës paraprake duhet lavdëruar për këtë.

Raste e rralla kur është vepruar në kundërshtim me këtë rregull kanë qenë rezultat i komunikimit të dobët mes gjyqtarit të procedurës paraprake, prokurorit dhe/ose avokatit mbrojtës.

Në një lëndë që kishte të bëjë me një të dyshuar të arrestuar sipas akuzës për legalizim të përmbajtjes së pavërtetë<sup>26</sup> në një gjykatë komunale nga rajoni i Prizrenit, të shqyrtuar në qershor 2008, avokati mbrojtës i angazhuar ishte informuar fillimisht nga prokurori që rasti do të procedohej në procedurë të rregullt, domethënë pa paraburgim. Më pas prokurori ndryshoi mendimin dhe vendosi që të kërkojë paraburgim, por me sa duket nuk e kishte informuar për këtë avokatin mbrojtës. Kur gjyqtari i procedurës paraprake e ftoi avokatin mbrojtës në seancë dëgjimi, ai gjendej në një komunë tjetër dhe iu nevojitën dy orë për të arritur në gjykatë. Kjo jo vetëm që ishte kohë e humbur nga prokurori dhe gjyqtari i procedurës paraprake, por në ndërkohë gjithashtu rezultoi edhe në

---

gjyqtari (si në rast të arrestimit në det, etj) shih, paragrafët 58-62 të Aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Brogan kundër MB-së*, të datës 29 nëntor 1988.

<sup>23</sup> Shih nenin 5 të Ligjit për Plotësimin dhe Ndryshim e Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës nr. 2003/26, të shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 44 të 22 dhjetorit 2008. Vlen të përmendet, ndryshimet e anashkaluan nenin 212(4) të PKKKP-së, i cili vazhdon të thotë që çdo person i privuar lirie do të duhej të dërgohet para një gjyqtari brenda 72 orëve prej kohës së arrestimit. Megjithatë, rregulla e 48 orëve e përcaktuar me nenin e ndryshuar 212(4) të KPPPK-së do të duhej të konsiderohet që shfuqizon atë të mëparshmin meqë e pason në kohë. Gjithashtu vlen të përmendet, Kushtetuta e Kosovës, neni 29, kërkon që i pandehuri të dërgohet para një gjyqtari brenda 48 orëve, duke i lejuar gjithashtu gjyqtarit të procedurës paraprake një afat prej 48 orëve shtesë për të vendosur mbi paraburgimin.

<sup>24</sup> Neni 212(4) KPPPK.

<sup>25</sup> Këto të dhëna statistikore bazohen në monitorimin dhe analizimin e drejtpërdrejtë të OSBE-së të 125 lëndëve që kanë të bëjnë me procedurat e paraburgimin para gjykatave komunale dhe të qarkut në Kosovë, gjatë periudhës kohore 1 janar 2008 dhe 30 shtator 2008.

<sup>26</sup> Neni 334, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/25, të 6 korrikut 2003, me ndryshimet pasuese (KPPK).

kalimin e periudhës së arrestit policor, kështu që urdhri për paraburgim, kur më në fund u zbatua, erdhi një orë e gjysmë pas kalimit të periudhës maksimale të mbajtjes në polici.

Fakti që kjo periudhë “pezull” ishte relativisht e shkurtër nuk ka shumë rëndësi, meqë GjEDNj kishte gjetur shkelje të së drejtës për liri madje edhe kur personi është mbajtur në ndalim për vetëm 40 minuta pasi që paraburgimi i tij ishte bërë i paligjshëm për shkak të skadimit të periudhës kohore të paraburgimit të përcaktuar me ligj.<sup>27</sup> Sipas së drejtës lëndore të GjEDNj-së, autoritetet përgjegjëse për paraburgim duhet të rregullojnë të gjitha formalitetet administrative me shpejtësi, si dhe të përkujdesen që të sigurojnë se nuk tejkalohej kohëzgjatja e lejuar e paraburgimit.<sup>28</sup> Në rastin e përshkruar më lart, seanca e dëgjimit e paraburgimit do të duhej të kishte filluar më herët dhe avokati mbrojtës do të duhej të ishte informuar mbi seancën e dëgjimit në kohë të duhur.

Përgjithësisht, nuk janë vërejtur probleme të konsiderueshme me kohën e mbajtjes së seancave të dëgjimit gjatë periudhës së monitorimit. OSBE-ja ka vazhduar të monitorojë seancat e dëgjimit të paraburgimit, megjithëse me më pak intensitet, edhe pas miratimit të rregullit të ri 48 orësh për ndalim policor. Është evidente se reduktimi i kohëzgjatjes së arrestit policor prej 72 në 48 orë ka detyruar agjencitë e zbatimit të ligjit që të veprojnë më me shpejtësi në rastet që kërkojnë urdhër për paraburgim. Megjithatë, përkundër një hutimi fillestar për sa i përket standardit që duhet zbatuar,<sup>29</sup> duket se policët dhe prokurorët e Kosovës janë përshtatur mirë me rregullin e ri 48 orësh, si dhe vazhdojnë t'i respektojnë si duhet kufizimet kohore të përcaktuara me ligj për sjelljen e personave të arrestuar para gjyqtarit.

Policët, prokurorët dhe gjyqtarët e procedurës paraprake duhet të lavdërohen për respektimin me vigjilencë të rregullit që përcakton lëshimin e urdhrave të paraburgimit brenda afatit kohor ligjor. Për të siguruar që paraburgimi në pritje të gjykimit do të

---

<sup>27</sup> Shih *K.-F. kundër Gjermanisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 27 nëntor 1997, paragrafi 73.

<sup>28</sup> *Po aty*, paragrafi 72. Shih edhe *Giulia Manzoni kundër Italisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së, i datës 1 korrik 1997, paragrafi 25.

<sup>29</sup> Hutimi lindi nga fakti që kushtetuta, e miratuar më 15 qershor 2008, përcakton rregullin 48 orësh për sjelljen e personave të ndaluar para gjykatësit të procedurës paraprake, gjersa KPPPK vazhdon të përcaktojë rregullin 72 orësh. KPPPK-ja është ndryshuar dhe sjellë në pajtueshmëri me rregullin e obligueshëm 48 orësh sipas kushtetutës në dhjetor 2008 (përveç nenit 14 të KPPPK-së, që çuditërisht mbeti i pandryshuar dhe sot e kësaj dite vazhdon të përcaktojë rregullin 72 orësh). Deri në arritjen e ndryshimeve në KPPPK në dhjetor 2008, Policia e Kosovës, prokurorët dhe gjyqtarët nuk ishin të sigurt se cilin rregull ta zbatojnë: rregullin 48 orësh të përcaktuar me kushtetutë apo rregullin 72 orësh të përcaktuar me KPPPK. Gjatë kësaj periudhe, disa organe të zbatimit të ligjit dhe disa zyrtarë gjyqësorë kanë zbatuar rregullin 48 orësh, duke argumentuar se kushtetuta ka fuqi supreme ligjore dhe është mbi çdo ligj që është në kundërshtim, gjersa të tjerët vazhdonin të zbatonin rregullin 72 orësh, duke argumentuar se KPPPK mbizotëron si *lex specialis* mbi kushtetutën. Në përpjekje për të zgjidhur këtë hutim dhe për të sjellë njëtrajtshmëri në praktikën e urdhërimit të paraburgimeve fillestare, disa kryeprokurorë të qarkut lëshuan udhëzime për të gjithë prokurorët vartës duke i udhëzuar që të ndjekin rregullin e kushtetutës; megjithatë, ky udhëzim u anulua pak kohë më vonë, në pritje të ndryshimeve në KPPPK. Konfuzioni në fund u qartësua në dhjetor 2008 kur edhe u ndryshua KPPPK-ja duke u sjellë në pajtueshmëri me rregullin 48 orësh të përcaktuar në kushtetutë. Që atëherë, ky rregull është duke u ndjekur në mënyrë të njëtrajtshme nga të gjithë policët, prokurorët publikë dhe gjykatësit e procedurës paraprake të Kosovës.



zbatohet gjithmonë brenda 48 orëve pas arrestimit policor, bashkëpunimi ndërmjet policisë, prokurorëve dhe gjyqtarëve të procedurës paraprake duhet të mbahet në nivel të lartë dhe, nëse ka nevojë, të forcohet edhe më shumë.

## **B. Kallëzimet penale të vonuara**

Në mënyrë që prokurorët të jenë në gjendje të hartojnë kërkesa adekuate dhe të arsyeshme për paraburgim, ata duhet të pranojnë kallëzimet penale sa më shpejtë që të jetë e mundur. OSBE-ja është e shqetësuar se në disa raste të monitoruara, policët e Kosovës nuk i kanë siguruar prokurorit kopje të dosjes policore pa vonesë.

Bazuar në informatat në dispozicion të OSBE-së, policia i ka sjellë rastet para prokurorisë mesatarisht 46 orë pas arrestimit – tregues i kënaqshëm ky duke pasur parasysh se gjatë periudhës së monitorimit ishte në fuqi rregulli 72 orësh për ndalim policor. Megjithatë, OSBE-ja ka monitoruar së paku 15 raste ku policia i solli prokurorëve rastet rreth dhjetë orë para skadimit të periudhës së ndalimit fillestar. Veç kësaj, në së paku tri raste të monitoruara, kallëzimet penale janë sjellë para prokurorëve dy orë apo më pak para skadimit të kohëzgjatjes së ndalimit policor.

Në një rast para Gjykatës së qarkut në Pejë, policia kishte ndaluar një të pandehur për dyshim të vrasjes<sup>30</sup> më 17 gusht 2008. Policia solli kallëzimin penal në zyrën e prokurorit publik vetëm dy orë para skadimit të afatit të ndalimit. Prokurori me shpejtësi hartoi kërkesën për paraburgim dhe i pandehuri u paraqit para gjykatësit të procedurës paraprake një orë e gjysmë më vonë. Padyshim se kjo shkaktoi shkelje të afatit 72 orësh që ishte në fuqi atëkohë për lëshimin e vendimit për paraburgim, meqë 30 minuta vështirë se janë kohë e mjaftueshme për gjykatësin që të mbajë seancë dëgjimi dhe të dorëzojë aktvendim adekuat të arsyeshëm për paraburgim.

Dorëzimi me vonesë i raporteve policore nuk u lë prokurorëve kohë të mjaftueshme që të shqyrtojnë dosjen policore me kujdes dhe të hartojnë kërkesë për paraburgim të mbështetur me argumente relevante dhe të mjaftueshme, duke i detyruar ata që të vazhdojnë me kërkesa me arsyetim të pamjaftueshëm për paraburgim. Në të vërtetë, për të qenë në pajtueshmëri me afatet kohore ligjore, në raste të tilla, prokurorët nuk mund të parashtrajnë tjetër veçse një kërkesë standarde të bazuar në një shabllon që përmban riformulim të bazave ligjore për paraburgim dhe disa arsyetime abstrakte. Si rrjedhim, një gjë e tillë ka ndikim në aftësinë e avokatit mbrojtës që në mënyrë efektive ta sfidojë nevojën për paraburgim, si dhe në kapacitetin e gjyqtarët të procedurës paraprake për të urdhëruar paraburgimin përmes një vendimi të arsyetuar mirë.

Prandaj, policët duhet gjithmonë të dorëzojnë kallëzimet e tyre penale pranë prokurorisë sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe pa vonesa të paarsyeshme.

---

<sup>30</sup> Neni 147 KPPK.

### C. Kërkesat e paarsyetuara të prokurorëve për paraburgim

Sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ekziston prezumimi në favor të lirisë së pandehurit në pritje të gjyqimit.<sup>31</sup> GjEDNJ përcakton që “paraburgimi mund të arsyetohet në raste të caktuara vetëm kur ka indikacione specifike të kërkesës së vërtetë të interesit publik që, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, mbizotëron ndaj rregullit të respektimit të lirisë së individit.”<sup>32</sup> Prandaj, përveç nëse ka arsye relevante dhe të mjaftueshme për të urdhëruar paraburgimin ndaj një të pandehuri, atij/asaj duhet t’i caktohet një masë më e butë ose të hetohet dhe të gjykohet në liri.

Përfundimi i këtij parimi, i cili mund të quhet “prezumimi i lirisë”, është së barra qëndron te autoritetet publike – dhe më saktësisht, te prokurori – për të dëshmuar se paraburgimi është i domosdoshëm në rrethanat specifike të rastit. Nëse prokurori nuk arrin të dëshmojë se ekziston kjo nevojë, i pandehuri duhet të lirohet.

Në pajtim me standardet ndërkombëtare, KPPPK-ja përcakton që paraburgimi në pritje të gjyqimit mund të urdhërohet vetëm nga gjykatësi i procedurës paraprake pas “kërkesës me shkrim” të prokurorit publik dhe pas seancës së dëgjimit.<sup>33</sup> Në seancë të dëgjimit prokurori publik duhet të “paraqesë arsyet për kërkim të paraburgimit.”<sup>34</sup>

OSBE-ja ka vërejtur se në disa raste të monitoruara, prokurorët nuk kanë arritur të dëshmojnë “dyshimin e bazuar” se i pandehuri ka kryer vepër penale, që është kushti i parë që duhet shqyrtuar nga gjykatësi i procedurës paraprake para se të shqiptojë paraburgimin. Shumë prokurorë kanë trajtuar elementin e “dyshimit të bazuar” vetëm kalimthi, pa ofruar fakte që arsyetojnë dyshimin e bazuar se i pandehuri ka shkaktuar vepër penale, ndërsa e kanë bazuar kërkesën e tyre në ekzistencën e tri kushteve për paraburgim sipas nenit 281(1)2(i-iii) të KPPPK-së.<sup>35</sup>

Për sa i përket këtyre kushteve për paraburgim (elementet e kërkuara sipas paragrafëve (i)–(iii) të nenit 281(1) të KPPPK-së), OSBE-ja ka vërejtur se në më shumë se gjysmën e rasteve të monitoruara, prokurorët nuk kanë arritur të mbështesin kërkesat e tyre për paraburgim me arsye adekuate. Argumentet e parashtruara nga prokurorët shpeshherë ishin të paqarta, teorike, abstrakte dhe shabllone, si dhe nuk mund të dëshmonin me arsye bindëse dhe specifike arsyet me të cilat të pandehurit në rastet në fjalë duhej të privoheshin nga liria.

---

<sup>31</sup> Neni 5(1) GjEDNJ.

<sup>32</sup> Shih *Labita kundër Italisë*, aktgjykimi i GjEDNJ-së, i datës 6 prill 2000, paragrafi 152.

<sup>33</sup> Shih nenin 282(1) KPPPK.

<sup>34</sup> Shih nenin 282(5) KPPPK. Në praktikë, në shumë raste prokurorët përfshijnë të gjitha argumentet e tyre në favor të paraburgimit në kërkesën e tyre me shkrim dhe pastaj thjeshtë e përcjellin atë në seancën e dëgjimit.

<sup>35</sup> Kjo ndodhë shumë shpesh në rajonin e Pejës, për shembull, ku prokurorët zakonisht parashtrajnë propozimin për paraburgim bashkë me vendimin për të iniciuar hetimet. Ndonëse kjo është legjitime në vetvete, OSBE-ja the ka vërejtur shumë raste ku prokurorët e Pejës kanë trajtuar çështjen e dyshimit të bazuar në vendim për inicim të hetimeve, si dhe çështjen e tri bazave në kërkesë për paraburgim. Megjithatë këto janë dy akte të ndryshme elementi i dyshimit të bazuar duhet të përcaktohet po aq mirë edhe në kërkesën për paraburgim.

Rastet në vijim mund të shërbejnë si shembuj të kërkesave me arsyetim të pamjaftueshëm për paraburgim:<sup>36</sup>

Në një lëndë para Gjykatës së qarkut në Pejë që përfshinte dy të pandehur të dyshuar për blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar të substancave të rrezikshme narkotike dhe psikotropike,<sup>37</sup> më 30 qershor 2008, prokurori publik parashtroi kërkesë për caktimin e paraburgimit me arsyet si në vijim: “Baza e parë ligjore arsyetohet me faktin se nëse të pandehurit e lartpërmendur lirohen ekziston rreziku se mund të arratisen dhe pengojnë mbarëvajtjen normale të procedurës penale. Baza e dytë ligjore arsyetohet me faktin se nëse të pandehurit lirohen, ata mund të ushtrojnë ndikim ndaj dëshmitarëve [...]. Baza e tretë ligjore arsyetohet me faktin që nga natyra e veprës rezulton se nëse të pandehurit janë në liri ata mund të përsëritin veprën apo të kryejnë vepra të ngjashme. Prokurori publik gjithashtu mori në konsideratë masat tjera, mirëpo konstatoi se masa e paraburgimit është masa më adekuate për të siguruar dëshmitë që mbështesin dyshimin e bazuar.”

Në një lëndë që përfshinte një të pandehur të akuzuar për rrëmbim,<sup>38</sup> më 16 mars 2006, prokurori publik i qarkut në Gjilan parashtroi kërkesë për paraburgim duke theksuar se “ka frikë të bazuar se nëse [i pandehuri] lirohet ai mund të arratiset duke kaluar kufirin e Kosovës pa pengesë.” Rreziku i thirrur i arratisjes ishte lënë tërësisht i pambështetur, por prokurori fatmirësisht kishte sjellë dhe ishte mbështetur në baza tjera për paraburgim.

Në një rast para Gjykatës komunale në Prizren që përfshinte dy të pandehur të akuzuar me veprat penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm<sup>39</sup> dhe shmangie e qëllim të obligimeve,<sup>40</sup> më 6 qershor 2008 prokurori publik komunal parashtroi kërkesë për paraburgim me arsyetimet si në vijim: “Arsyet për urdhër për paraburgim përbëhen nga dispozitat e nenit 281, paragrafit 1, nënparagrafit 1 dhe 2, pika (i) dhe (ii), duke marrë parasysh se ka dyshim të bazuar se të pandehurit kanë kryer vepër penale, procedurat hetimore kundër tyre janë në vazhdim e sipër, dhe se nëse të pandehurit lirohen, ata mund të pengojnë mbarëvajtjen e procedurës penale, që do të thotë se ata mund të arratisen apo të shkatërrojnë fshehin, ndryshojnë apo falsifikojnë provat e veprës penale, prandaj besoj se ka arsye të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar paraburgim kundër të pandehurve.”

Shembujt e mësipërm përfaqësojnë një numër të madh të kërkesave për paraburgim të parashtruara nga prokurorët e Kosovës dhe ilustronë se prokurorët shpeshherë vetëm parafrazojnë dispozitat e nenit 281 të KPPPK-së, pa i ndërlidhur ato me rrethanat specifike të rastit, si dhe pa ofruar argumente konkrete që dëshmojnë se paraburgimi i të pandehurit

---

<sup>36</sup> Përveç nëse theksohet ndryshe, të gjitha përkthimet janë jozyrtare.

<sup>37</sup> Neni 229 KPPPK.

<sup>38</sup> Neni 159 KPPK.

<sup>39</sup> Neni 291(1) KPPK.

<sup>40</sup> Neni 92(b), Rregullorja e UNMIK-ut 2004/1 mbi Kodin Doganor të Kosovës, 30 janar 2004).

është vërtetë i domosdoshëm. Së fundi, vetëm në shumë pak raste të monitoruara prokurorët dëshmonin (apo argumentonin) bindshëm se masat tjera, përveç paraburgimit, janë të pamjaftueshme për të arritur qëllimin e njëjtë me atë të paraburgimit. Megjithatë, ky është parakusht i domosdoshëm për zbatimin e paraburgimit,<sup>41</sup> prandaj duhet të përcaktohet në mënyrë bindëse në secilin rast, krahas kushteve tjera të përcaktuara me ligj.

Një arsye pse prokurorët shpeshherë nuk arrijnë të lëshojnë kërkesa të arsyetuara si duhet për paraburgim mund të jetë fakti që policia në disa raste dorëzon me mjaft vonesë kallëzimet penale, afër skadimit të periudhës së ndalimit fillestar, duke mos lënë kështu kohë të mjaftueshme për hartimin e një kërkesë adekuate.<sup>42</sup> Veç kësaj, OSBE-ja ka vërejtur se disa vonesa i atribuohen zyrove të regjistrimit të prokurorisë, të cilave nganjëherë iu duhet kohë e gjatë për regjistrimin e dosjes policore dhe përcjelljen e saj te prokurori kompetent; në raste të tilla, përgjegjës është organizimi i brendshëm i zyrove të prokurorisë – jo policia apo prokurori përkatës. Megjithatë, përgjegjësia për përgatitjen e kërkesave adekuate për paraburgim në përgjithësi qëndron drejtpërdrejt te prokurorët.

Në përmbledhje, në shumicën e rasteve të monitoruara nga OSBE-ja, prokurorët nuk arrinin të mbështesnin kërkesat e tyre për paraburgim me informata të mjaftueshme faktike që mbështesin nevojën për paraburgim. Po ashtu, shumica e kërkesave për vazhdim të paraburgimit hartoheshin ngjashëm, me mungesë të arsyetimit; në të vërtetë, shumë kërkesa të tilla thjeshtë i referoheshin kërkesës fillestare për caktimin e paraburgimit, pa shtjellim të mëtutjeshëm për nevojën e vazhdimin të paraburgimit.

Arsyetimi i pamjaftueshëm i kërkesave të prokurorëve për paraburgim vështirëson punën e avokatëve mbrojtës për kundërshtimin e nevojës për paraburgim, si dhe ndërlikon detyrën e gjykatësit të procedurës paraprake për lëshimin e aktvendimit të arsyetuar për urdhërimin e paraburgimit, nëse ka nevojë. Prandaj, prokurorët duhet të bëjnë përpjekje për të përmirësuar aftësitë e tyre të arsyetimit, si dhe duhet të mbështesin të gjitha kërkesat e tyre për paraburgim me arsye adekuate të vërtetuara me rrethanat specifike faktike. Meqë barra e dëshmimit të nevojës për paraburgim doemos bie mbi prokurorin, si dhe duke pasur parasysh prezumimin në favor të lirisë, gjykatësit e procedurës paraprake duhet të kundërshtojnë kërkesat që nuk arrijnë ta dëshmojnë ekzistimin e bazave për paraburgim.

#### **D. Kryerje e dobët e detyrave nga ana e avokatëve mbrojtës**

KPPPK përcakton që gjatë seancave të dëgjimit për paraburgim, të pandehurit duhet të shoqërohen gjithmonë nga avokati mbrojtës.<sup>43</sup> OSBE-ja ka vërejtur se gjykatat e kanë siguruar këtë të drejtë në 97% të rasteve të monitoruara, që është rezultat mjaft i kënaqshëm në përgjithësi.

---

<sup>41</sup> Neni 281(1)3 KPPPK.

<sup>42</sup> Në çdo rast, ndonëse shpeshherë kërkesa për paraburgim është hartuar në të njëjtën ditë kur është mbajtur seanca e dëgjimit, si dhe kallëzimet penale po ashtu janë dërguar te prokurori në të njëjtën ditë, prokurori publik duhet të ketë qenë në dijeni mbi nevojën potenciale për paraburgim të të pandehurit afro tri ditë para seancës së dëgjimit, që do të thotë në momentin në arrestimit të të pandehurit (Shih nenin 212(2) KPPPK), dhe në këtë mënyrë prokurori ka mundur t'i iniciojë hetimet më herët.

<sup>43</sup> Neni 73(1)2 KPPPK.

Megjithatë, në të njëjtën kohë, OSBE-ja është e brengosur për cilësinë e përfaqësimit ligjor të ofruar për të pandehurit të cilët rrezikohen me paraburgim. Në afro një të tretën e rasteve të monitoruara, avokatët mbrojtës nuk kanë kundërshtuar propozimet e prokurorëve për paraburgim me argumente të arsyetuara. Në disa raste, argumentet e avokatëve mbrojtës përbëheshin vetëm nga kërkesat para gjyqtarëve për të mos shqiptuar paraburgimin ndaj klientëve të tyre, të pambështetura me arsye bindëse.

Madje edhe më shqetësues është fakti se në disa raste të monitoruara, avokatët mbrojtës nuk e kundërshtonin madje as propozimin e prokurorëve për paraburgimin, si dhe në vend të kësaj e pranonin atë.

Në një rast para Gjykatës së qarkut të Mitrovicës, më 28 shkurt 2008, një gjykatës i procedurës paraprake mbajti një seancë dëgjimi për paraburgim kundër një të pandehuri të dyshuar për vrasje të rëndë.<sup>44</sup> Në seancë të dëgjimit, avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata ngriti çështjen e sëmundjes së mundshme mendore të të pandehurit por u pajtua me prokurorin se rrethanat dhe rrezikshmëria e veprës penale arsyetonin paraburgimin e klientit të tij. Avokati nuk kundërshtoi paraburgimin dhe nuk sugjeroi asnjë alternativë tjetër që përfshinte trajtimin mjekësor, kështu që u detyrua të intervenonte vetë i pandehuri dhe të deklarojë se nuk ndjehet i sëmurë mendërisht dhe se kundërshtonte paraburgimin. Në këtë lëndë u zbatua paraburgimi në pritje të gjykimit, që u vazhdua edhe më vonë.

Gjithashtu, OSBE-ja ka vërejtur që, mesatarisht, avokatët e caktuar nga gjykata kanë pasur performancë më të dobët se avokatët mbrojtës të zgjedhur nga të pandehurit.<sup>45</sup>

Përderisa është e vërtetë që barra e provës për arsyetimin e nevojës për paraburgim i përket prokurorëve, avokatët mbrojtës luajnë rol thelbësor në mbrojtjen e të drejtës së individit për liri, dhe në këtë mënyrë duhet të jenë aktivë dhe efikas në përpjekjet e tyre për hedhjen poshtë të argumenteve të prokurorëve për paraburgim. Avokatët mbrojtës nuk janë të detyruar që të mos pajtohen me të gjitha propozimet e prokurorëve, por ata gjithmonë duhet të bëjnë përpjekje që ta mbështesin interesin e klientëve të tyre dhe duhet t'i ushtrojnë detyrat e tyre profesionale me përgjegjësi dhe me zell.<sup>46</sup>

Një pjesë e arsyes pse avokatët mbrojtës kanë dështuar të hedhin poshtë në mënyrë efektive kërkesat e prokurorëve për paraburgim në mbi një të tretën e lëndëve të monitoruara qëndron në kohën e kufizuar që u jepet avokatëve mbrojtës për t'u përgatitur për seancën e dëgjimit për caktimin e paraburgimit. OSBE-ja ka vënë në dukje që në disa lëndë të monitoruara, avokatët mbrojtës janë emëruar nga gjykata vetëm disa minuta para fillimit të seancës së dëgjimit për caktimin e paraburgimit. Njëherë, në një seancë të dëgjimit, avokatëve u janë shpërndarë kopjet e aktvendimit të prokurorëve për iniciimin e

---

<sup>44</sup> Neni 147 KPPK.

<sup>45</sup> Për më shumë hollësi shih raportin mujor të SMSL të OSBE-së: Kryerja e dobët e detyrave nga ana e avokatëve mbrojtës të caktuar sipas detyrës zyrtare ndikon në të drejtat e të pandehurit gjatë gjykimit dhe shkel obligimin e avokatit mbrojtës për të dhënë përkushtimin e duhur (janar 2009).

<sup>46</sup> Shih nenet 6 dhe 8, të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatëve, Oda e Avokatëve të Kosovës, Prishtinë, 7 korrik 2007 (Kodi i Etikës Profesionale).

hetimeve dhe kërkesa për paraburgim. Ky afat kohor vështirë se ua ka mundësuar avokatëve mbrojtës që të përgatiten dhe paraqesin mbrojtje adekuate për klientët e tyre. Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut parashohin që çdo person ka të drejtë për kohë dhe lehtësi adekuate për përgatitjen e mbrojtjes.<sup>47</sup> Në mënyrë të ngjashme, KPPPK përcakton që “[i] pandehuri ka të drejtë të ketë kohë adekuate për përgatitjen e mbrojtjes së tij.”<sup>48</sup>

Çështje tjetër është qasja në lëndën e prokurorit që mund t’i lejohet apo të mos i lejohet avokatit mbrojtës, në mënyrë që ai të jetë në gjendje t’i përgatisë argumentet për ta kundërshtuar nevojën për paraburgim. Në mënyrë që avokatit mbrojtës t’i lejohet kryerja e punës së tij në mënyrë efikase dhe të sigurojë barazinë e palëve në procedurë,<sup>49</sup> standardet ndërkombëtare parashohin që avokatëve mbrojtës duhet t’i sigurohet qasje në dosjen e rastit të hetimit që është thelbësore për ta kundërshtuar në mënyrë efektive ligjshmërinë e paraburgimit.<sup>50</sup> Ndonëse shihet e nevojshme që disa pjesë të shkresave të lëndës së hetimit të mbahen sekrete për shkak të hetimeve penale në zhvillim e sipër, konfidencialiteti nuk mund të ruhet në llogari të kufizimeve thelbësore të së drejtës në mbrojtje, dhe në këtë mënyrë informata që është thelbësore për ta vlerësuar ligjshmërinë e paraburgimit duhet t’i lihet në dispozicion në mënyrë të duhur avokatit të të dyshuarit.<sup>51</sup>

Prandaj, prokurorët dhe gjyqtarët e procedurës paraprake duhet t’u sigurojnë avokatëve mbrojtës qasje në dokumentet e nevojshme të shkresave të lëndës, deri në masën më të madhe të mundshme gjatë hetimeve që janë në zhvillim e sipër, në mënyrë që ata të jenë në gjendje që në mënyrë efektive ta kundërshtojnë nevojën për paraburgim. Avokati mbrojtës gjithashtu duhet të njoftohet sa më shpejtë që të jetë e mundur për seancën e planifikuar të dëgjimit, në mënyrë që të kenë kohë të përgatiten siç duhet për këtë lëndë. Pastaj, avokati mbrojtës duhet t’i kryej detyrat e tij me përgjegjësi dhe zell dhe jo thjeshtë t’i paraqesë deklaratat e standardizuara dhe shabllone.

## **E. Mungesa e seancës së dëgjimit për caktimin e paraburgimit në disa raste**

Sipas standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, çdo person i arrestuar ka të drejtë të “sjellët pa vonesë para gjyqtarit.”<sup>52</sup> Kjo nënkupton që i pandehuri duhet fizikisht

---

<sup>47</sup> Neni 6 i KEDNj-së. Kjo kërkesë bazë për gjykim të drejtë duhet të interpretohet, në rast të seancës dëgjimore për caktimin e paraburgimit, në lidhje me nevojën për ta mbajtur seancën e dëgjimit për caktimin e paraburgimit me përpikëri, brenda afatit kohor të përcaktuar me ligj.

<sup>48</sup> Neni 12(1) i KPPPK-së.

<sup>49</sup> Në *Shishkov kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i GjEDNj më 9 janar 2003, paragrafi 77, Gjykata Evropiane ka konstatuar që seancat e dëgjimit për caktimin e paraburgimit “në parim duhet t’i plotësojnë, deri në masën më të madhe të mundshme në rrethana të hetimeve që janë në zhvillim e sipër, kërkesat themelore të gjykimit të drejtë,” duke përfshirë parimet e tilla si procedurat akuzuese dhe barazinë e palëve në procedurë.

<sup>50</sup> *Shih Musuc kundër Moldovës*, aktgjykimi i GjEDNj-së më 6 nëntor 2007, paragrafi 53.

<sup>51</sup> *Shih Lamy kundër Belgjikës*, aktgjykimi i GjEDNj-së më 30 mars 1989, paragrafi 29. *Shih gjithashtu Garcia Alva kundër Gjermanisë*, aktgjykim i GjEDNj-së më 13 shkurt 2001, paragrafi 39-43.

<sup>52</sup> Neni 9(3) PNDKP dhe Neni 5(3) KEDNj kanë pothuajse gjuhë identike: “Çdo person i arrestuar ose ndaluar [për shkak të ndonjë veprë] duhet të nxirret, pa vonesë, përpara një gjykatësi ose ndonjë zyrtari të

të paraqitet para gjyqtarit, normalisht në ‘seancën e dëgjimit’ për caktimin e paraburgimit.”<sup>53</sup> Kjo garanton mbrojtjen kundër keqtrajtimit të policisë dhe kundër ushtrimit arbitrar të pushtetit shtetëror dhe i ofron mundësi personit të arrestuar të kundërshtojë privimin e lirisë së tij/saj.<sup>54</sup>

KPPPK përmban dispozita të ngjashme. Aty parashihet që paraburgimi mund të shqiptohet vetëm pas seancës së dëgjimit;<sup>55</sup> pasi që personi i arrestuar të jetë sjellë te gjyqtari i procedurës paraprake, ai informohet për të drejtat e tij/saj;<sup>56</sup> avokati mbrojtës duhet të jetë i pranishëm në seancën e dëgjimit;<sup>57</sup> dhe që i pandehuri duhet të ketë mundësi t’i përgjigjet arsyeve të prokurorit për kërkim të paraburgimit.<sup>58</sup>

Përkundër këtyre dispozitave të qarta ligjore, OSBE-ja ka theksuar që, në disa lëndë, gjyqtarët kanë shqiptuar paraburgimin pa e mbajtur seancën e dëgjimit, duke mos e përfshirë të pandehurin dhe avokatin mbrojtës të tij/saj.

Në një rast para Gjykatës Komunale në Vushtrri, më 18 korrik 2008, policia arrestoi një të pandehur me supozim se ka kryer tri vepra penale të lëndimeve të lehta trupore.<sup>59</sup> Më 21 korrik 2008, prokurori paraqiti propozim për shqiptimin e masës për trajtim të detyrueshëm psikiatrik nën mbikëqyrje, që përmbante kërkesën për shqiptimin e paraburgimit. Në të njëjtën datë, kolegji prej tre gjyqtarësh, pa e mbajtur seancën e dëgjimit në prani të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës, ka lëshuar aktvendimin për shqiptimin e paraburgimit për një muaj.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prizren, më 11 maj 2008, policia arrestoi një të pandehur të akuzuar për shkaktim të lëndimeve të rënda trupore.<sup>60</sup> Më 14 maj 2008, prokurori ngriti aktakuzë që përmbante propozim për paraburgim. Në të njëjtën ditë, kolegji prej tre gjyqtarësh urdhëroi paraburgimin për një muaj. Gjykata nuk i dëgjoi as të pandehurin, as avokatin mbrojtës.

---

autorizuar me ligj për ushtrimin e funksioneve gjyqësore dhe duhet të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet [...]”

<sup>53</sup> Praktika gjyqësore e GjEDNj-së tregon qartë që kur prokurori kërkon paraburgim kundër personit të arrestuar “kërkohet seancë dëgjimi” (shih *Wloch kundër Polonisë*, aktvendim i GjEDNj-së, më 19 tetor 2000, paragrafi 126). Gjykata gjithashtu ka gjetur shkelje të nenit 5(3) të Konventës madje edhe ku një urdhër për arrest është lëshuar nga gjykata në prani të avokatit mbrojtës, por pa praninë e vetë të pandehurit (shih *McGoff kundër Suedisë*, aktvendimi i GjEDNj-së, më 26 tetor 1984, paragrafi 27).

<sup>54</sup> Sipas GjEDNj-së, “Vetë qëllimi i nenit 5 [është] ta mbrojtë individin nga arbitrariteti” (*Kurt kundër Turqisë*, 15/1997/799/1002, aktvendimi i GjEDNj-së, më 25 maj 1998, paragrafi 122).

<sup>55</sup> Shih nenin 282(1) KPPPK.

<sup>56</sup> Neni 282(2) KPPPK.

<sup>57</sup> Neni 282(3) KPPPK. Sipas nenit 282(4) të KPPPK-së, nëse i pandehuri nuk e angazhon avokatin mbrojtës, gjykata duhet të sigurojë një sipas detyrës zyrtare.

<sup>58</sup> Neni 282(5) i KPPPK.

<sup>59</sup> Neni 153 KPPK.

<sup>60</sup> Neni 154 KPPK.

Në një rast para Gjykatës Komunale në rajonin e Prishtinës, i pandehuri u arrestua nga policia, më 15 korrik 2008 nën dyshimin e kryerjes së veprës penale, vjedhje të rëndë,<sup>61</sup> duke shkaktuar lëndime të lehta trupore,<sup>62</sup> dhe dëmtim të pasurisë së luajtshme.<sup>63</sup> Në të njëjtën ditë, prokurori mori në pyetje të pandehurin dhe ngriti aktakuzë që përmbante propozim për paraburgim. Paneli i gjykatës komunale ka shqiptuar paraburgimin për një muaj, pa e mbajtur seancën e dëgjimit me personin e arrestuar dhe avokatin mbrojtës.

Në një rast para Gjykatës Komunale në Prizren, më 4 janar 2008, policia arrestoi të pandehurin që supozohej të ketë sulmuar zyrtarët gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.<sup>64</sup> Më 7 janar 2008, prokurori ngriti aktakuzën që përmbante propozim për shqiptimin e paraburgimit. Në të njëjtën datë, gjykata pranoi propozimin dhe urdhëroi paraburgimin për një muaj, pa e mbajtur seancën e dëgjimit në prani të të pandehurit dhe avokatit mbrojtës.

Në rastet e mësipërme, gjykatat kanë urdhëruar paraburgimin pa mbajtur seancat e dëgjimit në prani të pandehurve dhe avokatëve të tyre mbrojtës. Zbatimi i paraburgimit pa sjelljen e të pandehurit para gjyqtarit përbën shkelje si të kornizës ligjore të Kosovës ashtu edhe të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

OSBE-ja ka raportuar për këtë praktikë brengosëse në të kaluarën.<sup>65</sup> Me sa duket disa gjyqtarë dhe prokurorë ishin/janë të mendimit që gjykatat nuk kanë nevojë ta dëgjojnë personin e arrestuar (ose avokatin mbrojtës) nëse aktakuza përmban propozimin për caktim të paraburgimit me kërkesën e prokurorit<sup>66</sup> të ngritur para kalimit të afatit të arrestit policor.<sup>67</sup> Sipas mendimit të tyre, kolegji prej tre gjyqtarësh atëherë mund të marrë aktvendim “në letër” në bazë të propozimit të prokurorit që gjendet në aktakuzë, pa pasur nevojë të mbajnë seancën e dëgjimit me të pandehurin dhe avokatin mbrojtës të tij/saj.

Interpretimi i tillë i ligjit bie në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe të drejtën vendore. Pranimi i kërkesës për paraburgim që gjendet në aktakuzë nuk i liron autoritetet gjyqësore nga detyra për mbajtjen e seancës së dëgjimit lidhur me kërkesën për paraburgim. Neni 306(4) i KPPPK-së shërben për të vërtetuar që propozimi për urdhrin e paraburgimit që gjendet në aktakuzë duhet të vendoset nga kolegji prej tre gjyqtarësh (e jo nga gjyqtari i procedurës paraprake, siç ndodh zakonisht) dhe ai nuk e pezullon kërkesën e përgjithshme të nenit 282 të KPPPK-së, që paraburgimi mund të shqiptohet vetëm pas mbajtjes së seancës së dëgjimit.

Pas publikimit të raportit mbi këtë çështje të veçantë, OSBE-ja ka theksuar që ndërprerja e praktikës së zbatimit të paraburgimit pa mbajtjen e seancës së dëgjimit është për t’u çmuar

---

<sup>61</sup> Neni 253 KPPK.

<sup>62</sup> Neni 153 KPPK.

<sup>63</sup> Neni 260 KPPK.

<sup>64</sup> Neni 317 KPPK.

<sup>65</sup> Shih raportin mujor të SMSL të OSBE-së të muajit korrik 2008: Paraburgimi pa seancë të dëgjimit në prani të të pandehurit. Dështimi i gjykatave në mbajtjen e procesverbaleve të sakta të gjykimeve.

<sup>66</sup> Siç lejohet me nenin 306(4) KPPPK.

<sup>67</sup> Neni 212(4) KPPPK.



në gjykatat e rajonit të Mitrovicës; në rajonin e Gjilanit gjithashtu, paraburgimi shqiptohet gjithmonë pas seancës së dëgjimit, duke përfshirë të pandehurin dhe avokatin mbrojtës. Në të njëjtën kohë, praktika e dhënies së urdhrin për caktimin e paraburgimit, pa e mbajtur seancën e mirëfilltë të dëgjimit, vazhdon me të madhe pa pësuar ndonjë rënie në gjykatat e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës. Në këto rajone, në rastet kur aktakuza e ngritur përmban propozimin për caktimin e paraburgimit, kolegji prej tre gjyqtarësh ende vendos për paraburgim pa e mbajtur seancën e dëgjimit me pjesëmarrjen e të pandehurit dhe avokatit mbrojtës të tij/saj. Shumë prokurorë dhe gjyqtarë të procedurës paraprake si dhe avokatë mbrojtës vazhdojnë ta interpretojnë gabimisht nenin 306 të KPPPK-së dhe lejojnë një procedurën e tillë.

Si korniza ligjore e Kosovës ashtu edhe ajo ndërkombëtare e aplikueshme në Kosovë, kërkojnë që paraburgimi të zbatohet vetëm përmes seancës së dëgjimit, në të cilën i pandehuri dhe avokati mbrojtës paraqiten para gjyqtarit të procedurës paraprake dhe paraqesin rastin e tyre. Gjykatat gjithmonë duhet të marrin vendimin për paraburgim në prani të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës, duke i përfshirë edhe lëndët ku paraburgimi është kërkuar përmes propozimit që e përmban aktakuza. Për më tepër, seanca e dëgjimit për caktimin e paraburgimit, në parim duhet t'i plotësojë, sa më shumë që të jetë e mundur gjatë vazhdës së hetimeve, kërkesat themelore për gjykim të drejtë, që nënkupton që mbrojtjes duhet t'i sigurohet qasje e duhur në shkresat e lëndës së hetimeve, që janë të rëndësishme thelbësore për ta kundërshtuar në mënyrë efektive nevojën për paraburgim.<sup>68</sup> Dështimi për t'i sjellë personat e arrestuar para gjyqtarit përbën shkelje të drejtave të tyre themelore për liri. Për më tepër, bisedat në seancën gjyqësore të realizuara pa dëgjimin e të pandehurit gjithashtu shkelin të drejtën për ta mbrojtur veten dhe parimin e barazisë së armëve.<sup>69</sup>

Një praktikë ende e përhapur është shqiptimi i paraburgimit pa mbajtur seancën e mirëfilltë të dëgjimit me të pandehurin dhe avokatin e tij/saj mbrojtës, me gjyqtarin që merr vendim “në letër,” që është shkelje e rëndë e ligjeve të zbatueshme vendore dhe ndërkombëtare dhe duhet të ndërpritet menjëherë.

#### **IV. ARSYETIMI I AKTVENDIMEVE PËR PARABURGIM**

---

<sup>68</sup> Në *Shishkov kundër Bullgarisë* (aktvendimi i GJEDNJ-së, më 9 janar 2003, paragrafi 77) Gjykata Evropiane ka konstatuar që “Në rast se personi, paraburgimi i të cilit bie në kuadër të nenit 5 § 1 (c), kërkohet seancë e dëgjimit. Sa i përket ndikimit dramatik të privimit të lirisë për të drejtat themelore të personave në fjalë, procedurat e realizuara sipas nenit 5 § 4 të Konventës, në parim duhet të plotësojnë në masën më të madhe të mundshme sipas rrethanave të hetimeve që janë në zhvillim e sipër, kërkesat bazë të gjykimit të drejtë.”

<sup>69</sup> GJEDNJ ka konstatuar që: “Sa i përket ndikimit dramatik të cenimit të lirisë për të drejtat themelore të personit në fjalë, procedurat [që synon konstatimin e ligjshmërisë së paraburgimit] në parim duhet të plotësojnë, në masën më të madhe të mundshme në bazë të rrethanave të hetimeve që janë në zhvillim e sipër, kërkesat themelore të gjykimit të drejtë.” (*Shishkov kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i GJEDNJ-së më 9 janar 2003, paragrafi 77). Kërkesat e gjykimit të drejtë përfshijnë parimet e procedurave akuzuese dhe barazinë e palëve në procedurë (shih nenin 6 të KEDNJ-së).

Në të kaluarën, OSBE-ja ka raportuar për arsyetimin joadekuat të aktvendimeve për paraburgim.<sup>70</sup> OSBE-ja shprehu brengën rreth arsyetimeve të dobëta të aktvendimeve për paraburgim, si të atyre fillestare ashtu edhe atyre të vazhdimit, përkundër faktit që ligji ndërkombëtar dhe ai vendor kërkojnë arsyetim të plotë.<sup>71</sup>

Katër vite pas raportit të fundit mbi këtë temë, OSBE-ja vëren vetëm përmirësime të kufizuara në arsyetimin e aktvendimeve për caktimin e paraburgimit të nxjerra nga gjykatat e Kosovës. Në pjesën dërmuese të rasteve të monitoruara, gjyqtarët e procedurës paraprake kanë dështuar t'i arsyetojnë si duhet vendimet për paraburgim dhe si rrjedhim nuk i kanë plotësuar standardet ligjore të parapara në ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Duke i marrë parasysh të metat e përsëritura dhe ndërlikueshmërinë e çështjes, arsyetimi i aktvendimeve për paraburgim duhet të shqyrtohet dhe analizohet ndaras në pjesën e dytë të këtij raporti. Pjesa përkatëse do t'i analizojë në hollësi standardet ndërkombëtare dhe praktikën kosovare sa i përket caktimit të paraburgimit fillestar, vazhdimin e paraburgimit, arrestit shtëpiak dhe alternativat tjera kundrejt paraburgimit.

## **V. ZBATIMI I GABUESHËM I PARABURGIMIT NË PROCEDURËN E SHKURTËR**

Në procedura të shkurtra, përkatësisht rastet në lidhje me veprat për të cilat dënimi themelor është gjoba ose burgosja deri në tri vjet,<sup>72</sup> paraburgimi në procedurë penale mund të zbatohet vetëm “në raste të veçanta”.<sup>73</sup> Karakteri i jashtëzakonshëm i paraburgimit në raste të tilla reflektohet në kufizimet strikte të cilat ligji i parashikon mbi zbatimin e paraburgimit në procedurë të shkurtë, në krahasim me procedurat e zakonshme.<sup>74</sup> Arsyetimi për këtë është i qartë – pasi heqja e lirisë gjithmonë duhet parë si e jashtëzakonshme, zbatimi i paraburgimit në raste që përfshijnë vepra më të lehta duhet të kufizohet me masa mbrojtëse edhe më rigorozë. Për këtë arsye, neni 463(1)2 i KPPPK-së vendos disa kufij minimalë në formë dënimesh (vite burgimi) në lidhje me veprat për të cilat mund të zbatohet paraburgimi në procedurë të shkurtër.<sup>75</sup>

---

<sup>70</sup> Shih Shqyrtimin e OSBE-së të Sistemit të Drejtësisë Penale (prill 2003-tetor 2004): Vepra penale, paraburgimi dhe dënimi, (tetor 2004), faqe 32; shih gjithashtu Shqyrtimin e OSBE-së të Sistemit të Drejtësisë Penale (1999-2005): Reformat dhe brengat e mbetura (Mars 2006), faqe 52.

<sup>71</sup> Për të drejtën ndërkombëtare, shih *Belchev kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i 8 prillit 2004, paragrafi 82. Për kornizën ligjore të Kosovës, shih nenin 283(1) KPPPK dhe gjithashtu Qarkoren e Drejtësisë 2000/27, të datës 19 dhjetor 2000.

<sup>72</sup> Neni 461 KPPPK.

<sup>73</sup> Shih nenin 463(1) KPPPK.

<sup>74</sup> Shih nenin 463 KPPPK në krahasim me nenin 281 të KPPPK-së.

<sup>75</sup> Teknika e hartimit të nenit 463 të KPPPK-së tregon që këta kufij zbatohen vetëm tek procedurat e shpejta ku paraburgimi vendoset në bazë të rrezikut të frikësimit të dëshmitarëve apo pengimit të provave, apo në bazë të rrezikut të përsëritjes së veprës, por jo edhe për rrezikun e arratisjes - neni 463(1)1 i KPPPK-së, që i referohet rrezikut të arratisjes, nuk ka ankesë dhe zbatohet tek të gjitha rastet në procedurë të shpejtë, pa marrë parasysh dënimin që zbatohet për vepër. Kjo në vetvete ngrit disa pyetje dhe brenga, pasi ligji duket të lejojë paraburgimin e një personi që dyshohet të ketë kryer një vepër të dhunshme që dënohet me më pak se dy vjet kur ekziston rreziku që ai apo ajo mund të arratiset (Neni 463(1)1

OSBE-ja ka vërejtur që paraburgimi nganjëherë kërkohet nga prokurorët dhe shqiptohet nga gjykatësit në rastet e procedurës së shkurtër në lidhje me veprat penale për të cilat paraburgimi nuk mund të zbatohet fare me ligj.

Në një lëndë para Gjykatës komunale në Prizren në lidhje me një të pandehur të dyshuar për veprën e kanosjes,<sup>76</sup> më 19 gusht 2008 prokurori publik komunal parashitroi propozim-akuzën dhe kërkoi që i pandehuri të paraburgoset. Prokurori u mbështet tek neni 463(1)2 në ndërlidhje me nenin 281(1)2(iii) të KPPPK-së, pra në bazë të dyshimit të bazuar që i dyshuari ka kryer veprën, si dhe rrezikut që ai do ta përsërisë veprën, pasi që ky i fundit tanimë ishte i dyshuar në një rast tjetër të vonshëm në të cilin ai ishte akuzuar për veprën penale të lëndimit të lehtë trupor.<sup>77</sup> Në dëgjimin për paraburgim të mbajtur të njëjtën ditë, gjykata miratoi propozimin e prokurorit dhe vendosi të pandehurin në paraburgim për një muaj.

Në rastin e përshkruar më lart, pasi prokurori publik nuk është thirrur tek rreziku i arratisjes, paraburgimi mund të mendohet vetëm nëse vepra në fjalë është e dënueshme me dy apo më shumë vite burgimi, siç parashikohet shprehimisht me nenin 463(1)2(ii) të KPPPK-së. I pandehuri megjithatë ishte i dyshuar për vepër të dënueshme me gjobë apo burgim deri në një vit.<sup>78</sup> Pasi vepra e dyshuar penale ishte e dënueshme me maksimum një vjet, si dhe pasi që i vetmi rrezik që thirrej ishte ai i kryerjes së sërishme të veprës (dhe jo ai i arratisjes), paraburgimi nuk mund të caktohej në bazë të nenit 463(1)2(ii) të KPPPK-së. Megjithatë, prokurori kërkoi paraburgimin në bazë të së njëjtës dispozitë të ligjit dhe gjyqtari i procedurës paraprake e miratoi kërkesën e prokurorit dhe ia caktoi të pandehurit masën e paraburgimit prej një muaji.<sup>79</sup>

Në një rast tjetër para Gjykatës komunale në Glllogoc, katër të pandehur ishin vendosur në paraburgim, ndërsa shtatë të tjerë në arrest shtëpiak për gati një muaj nën akuzën e lëndimeve të lehta trupore<sup>80</sup> dhe pjesëmarrjes në përleshje.<sup>81</sup> Pasi këto akuza parashihen të dënohen maksimalisht deri në një vjet, si dhe pasi rreziku

---

KPPPK), por jo kur ka rrezik që ai apo ajo mund të përsërisë veprën (neni 463(1)2(ii) KPPPK). Kjo gjë nuk është plotësisht logjike, pasi rreziku që i pandehuri të përsërisë veprën e dhunshme (edhe nëse ajo vepër dënohet me më pak se dy vjet, pra nuk është aq e rëndë) mund të thuhet që nuk është më pak i rëndësishëm sesa rreziku që i pandehuri të arratiset pas veprës [së parë], që mund të jetë edhe më i rëndësishëm.

<sup>76</sup> Neni 161(2) KPPK.

<sup>77</sup> Neni 153 KPPK.

<sup>78</sup> Shih nenin 161(2) KPPK.

<sup>79</sup> Kufizimi i kohëzgjatjes së paraburgimit në procedurë penale prej 15 ditësh në procedurë të shpejtë, parashikuar me nenin 463(2) të KPPPK-së nuk është zbatuar në këtë rast sepse prokurori ka kërkuar paraburgim përmes ngritjes së aktakuzës së tij të shkurtër (derisa kufiri 15-ditësh vlen për paraburgimin para ngritjes së aktakuzës).

<sup>80</sup> Neni 153(1)4 KPPK.

<sup>81</sup> Neni 155(1) KPPK.

i arratisjes nuk është përmendur si bazë për paraburgim, as paraburgimi e as arresti shtëpiak<sup>82</sup> nuk kanë mundur të aplikohen sipas nenit 463 të KPPPK-së në këtë rast.

Në rastet e paraqitura më lart, kërkesat e prokurorëve dhe vendimet e gjykatave për paraburgim kanë qenë qartë shkelje e rregullave në lidhje me zbatimin e paraburgimit në procedura të shkurtra. Si të tilla, paraburgimi në ato raste është aplikuar në kundërshtim me ligjin vendor në fuqi, duke rezultuar kështu edhe në shkelje të standardeve të zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.<sup>83</sup>

Në çdo rast tek procedurat e shkurtra, prokurorët publikë dhe gjyqtarët e procedurës paraprake duhet që me kujdes të marrin parasysh nëse ligji lejon apo nuk lejon zbatimin e masës së paraburgimit.

## VI. KOHËZGJATJA E PARABURGIMIT NË PRITJE TË GJYKIMIT

Sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, çdokush që arrestohet apo mbahet “ka të drejtë të gjyqimit brenda një kohe të arsyeshme apo të lirohet në pritje të gjyqit.”<sup>84</sup> GjEDNj-ja ka theksuar disa herë që “paraburgimi i vazhduar mund të arsyetohet vetëm në rastet kur ka shenja të qarta të një interesi të vërtetë publik që, pavarësisht prezumimit të pafajësisë, e mbizotëron të drejtën për liri.”<sup>85</sup> Gjykata gjithashtu ka theksuar që për të pasur vazhdim të ligjshëm të paraburgimit, duhet të ketë, përveç dyshimit të bazuar të vazhdueshëm që personi i arrestuar ka kryer një vepër, edhe “baza tjera”, “të arsyeshme dhe të mjaftueshme”, të ngritura nga organet gjyqësore; si dhe autoritetet kompetente duhet të shprehin “kujdes të veçantë” në ndërmarrjen e procedurave.<sup>86</sup>

GjEDNj nuk ka pranuar të caktojë kohëzgjatjen maksimale të periudhës së “arsyeshme” të paraburgimit, duke deklaruar që arsyeshmëria e një periudhe të paraburgimit duhet vlerësuar duke iu referuar rrethanave të veçanta të secilit rast.<sup>87</sup> Gjykata ka pranuar që paraburgimi i zgjatur mund të arsyetohet në rastet që kanë të bëjnë me vepra veçanërisht komplekse,<sup>88</sup> dhe/ose të dyshimtë të shumtë, e sidomos të dyshimtë që nuk bashkëpunojnë.<sup>89</sup> Në anën tjetër, GjEDNj-ja nuk i ka pranuar periudhat e gjata të mungesës së aktivitetit në trajtimin e një rasti para gjyqit,<sup>90</sup> vonesat e shkaktuara nga

<sup>82</sup> Arresti shtëpiak duhet të zbatohet me të njëjtat rregulla si paraburgimi, shih nenet 278(7), 281(1) dhe 283(1) të KPPPK-së, kur merren parasysh në ndërlidhje. Shih edhe aktgjykimin e GjEDNj-së në rastin e *Vachev kundër Bullgarisë* (Aktgjykimi i 8 korrikut 2004, paragrafi 64) që barazon ngjashëm arrestin shtëpiak me paraburgimin në procedurë penale.

<sup>83</sup> Sipas nenit 5(1) të KEDNj, paraburgimi është i ligjshëm vetëm nëse aplikohet në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës.

<sup>84</sup> Neni 5(3) KEDNj.

<sup>85</sup> Shih *Punzelt kundër Republikës Çeke*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 25 prill 2000, paragrafi 73.

<sup>86</sup> Shih *Labita kundër Italisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së me datë 6 prill 2000, paragrafët 152 dhe 153.

<sup>87</sup> Shih *Stögmüller kundër Austrisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 10 nëntor 1969.

<sup>88</sup> Shih, për shembull, rastin *VV kundër Zvicrës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 26 janar 1993, në lidhje me një skemë të gjerë mashtrimi që përfshinte menaxhmentin e gjashtëdhjetë kompanive.

<sup>89</sup> Shih *VV kundër Zvicrës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 26 janar 1993.

<sup>90</sup> Shih *Assenov a. o. Kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 tetor 1998.

ekspertët,<sup>91</sup> mungesa e stafit,<sup>92</sup> praktikat joadekuate të punës,<sup>93</sup> si dhe vështirësitë që dalin nga nevoja për mbrojtjen e identitetit të një dëshmitari të mbrojtur<sup>94</sup>, si arsyetime për paraburgim të zgjatur.

KPPPK-ja ngjashëm parasheh që “Çdo heqje lirie, e sidomos kohëzgjatja e paraburgimit në procedurë penale, duhet zvogëluar në kohën sa më të shkurtër të mundshme.”<sup>95</sup> Kodi gjithashtu kërkon që çdo paraburgim të ndërpritet kur arsyet që e kanë kërkuar atë pushojnë së ekzistuari, apo të zëvendësohet me masa më të buta nëse kushtet për të njëjtën janë plotësuar.<sup>96</sup> KPPPK-ja shkon tutje duke vendosur kufizime strikte mbi kohëzgjatjen e paraburgimit. Aktvendimi i parë mund të urdhërojë paraburgimin e të pandehurit për më së shumti një muaj nga dita kur ai apo ajo është arrestuar.<sup>97</sup> Kodi gjithashtu kufizon kohëzgjatjen maksimale të paraburgimit para ngritjes të aktakuzës deri në tre muaj për rastet që dënohen me më pak se pesë vjet burg, si dhe në gjashtë muaj për rastet e veprave të dënueshme me së paku pesë vjet.<sup>98</sup> Vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, këto afate maksimale mund të zgjaten, deri në gjashtë muaj sipas rastit.<sup>99</sup>

Megjithatë, këto dispozita nuk respektohen gjithmonë në praktikë. OSBE-ja ka vërejtur raste të shkeljes të kohëzgjatjes së paraburgimit të lejuar me ligj edhe në aktvendimet e para mbi paraburgimin, por edhe në vendimet për zgjatjen e paraburgimit.

Në një lëndë në lidhje me një të pandehur të akuzuar për sulm ndaj personave zyrtarë në detyrë zyrtare,<sup>100</sup> më 7 janar 2008, gjykatësi i procedurës paraprake në Gjykatën komunale në Prizren, pas një seance jopublike të mbajtur në mungesë të të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës, lëshoi një aktvendim të parë mbi paraburgimin për një periudhë dymujore. Kjo, përkundër faktit që neni 284(1) i KPPPK-së thekson qartë që aktvendimi fillestar mbi paraburgimin në procedurë penale mund të vendosë paraburgim për një periudhë maksimale prej një muaji.

Janë vërejtur edhe disa probleme në lidhje me respektimin e kohëzgjatjes së duhur të paraburgimit në rastet në procedurë të shkurtër. Duke marrë parasysh peshën më të vogël të veprës së dyshuar penale,<sup>101</sup> në raste të tilla KPPPK-ja parasheh periudhë paraburgimi para ngritjes së aktakuzës në procedurë të shkurtër prej 15 ditësh.<sup>102</sup> Megjithatë, ky kufizim nuk respektohet gjithmonë në praktikë.

---

<sup>91</sup> Shih *Clooth kundër Belgjikës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 12 dhjetor 1991.

<sup>92</sup> Shih *Stögmüller kundër Austrisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 10 nëntor 1969; shih edhe *Muller kundër Francës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 17 mars 1997.

<sup>93</sup> Shih *Assenov a. o. kundër Bullgarisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 28 tetor 1998.

<sup>94</sup> Shih *Clooth kundër Belgjikës*, aktgjykimi i GjEDNj-së i datës 12 dhjetor 1991.

<sup>95</sup> Neni 5(3) KPPPK.

<sup>96</sup> Neni 268(1-3) KPPPK.

<sup>97</sup> Neni 284(1) KPPPK.

<sup>98</sup> Neni 284(2) KPPPK.

<sup>99</sup> Neni 284(3) KPPPK.

<sup>100</sup> Neni 317 KPPK.

<sup>101</sup> Procedurat e shkurtra zbatohen në rastet e veprave penale për të cilat dënimi parësor është me gjobë apo me burgim deri në 3 vjet, shih nenin 461 KPPPK.

<sup>102</sup> Neni 463(2) KPPPK.

Pas protestave të dhunshme që ndodhën më 9 janar 2009 gjatë një tubimi në xhaminë e fshatit Zabel i poshtëm të komunës Gllogoc, katër të pandehur u vendosën në paraburgim (më 9 janar 2009), ndërsa shtatë të tjerë në arrest shtëpiak (në data të ndryshme nga 9 deri më 14 janar 2009). Gjithë të pandehurit u mbajtën në paraburgim/arrest shtëpiak deri më 5 shkurt 2009. Pasi aktakuza në procedurë të shkurtër u ngrit më 3 shkurt 2009, paraburgimi i tyre kishte tejkaluar afatin maksimal të lejuar prej 15 ditësh në procedurë të shkurtër para ngritjes së aktakuzës. Si i tillë, paraburgimi i tyre pas skadimit të 15 ditëve të fillimit ishte në kundërshtim me nenin 463(2) e KPPPK-së, si dhe në shkelje të nenit 5(1) të KEDNj.<sup>103</sup>

Në një lëndë që kishte të bëjë me një shqiptar të dyshuar për shkaktim të lëndimeve të lehta trupore<sup>104</sup> ndaj një serbi, i pandehuri u arrestua fillimisht nga policia dhe u vendos në arrest shtëpiak nga Gjykata Komunale në Ferizaj për periudhën prej 5 shkurtit 2009 deri më 2 mars 2009. Aktakuza në procedurë të shkurtër nuk u ngrit më 8 maj 2009. Pasi që masa e arrestit shtëpiak duhet të zbatohet në respektim të garancive të njëjta si paraburgimi,<sup>105</sup> dhe aktakuza në procedurë të shkurtër ishte ngritur shumë më vonë se kalimi i 15 ditëve fillestare të arrestit shtëpiak, arresti shtëpiak i të pandehurit pas 15 ditëve të para ishte i paligjshëm sipas nenit 463(2) të KPPPK-së dhe nenit 5(1) të KEDNj-së.

Në një rast para Gjykatës Komunale në Mitrovicë, më 16 janar 2009, një i pandehur i dyshuar për lëndime të lehta trupore<sup>106</sup> dhe dëmtim të pronës së luajtshme<sup>107</sup> u vendos në paraburgim njëmuajor përmes aktvendimit të gjykatësit të procedurës paraprake të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit EULEX-it, në bazë të një kërkesë të parashtruar nga prokurori i EULEX-it. I pandehuri vazhdoi të mbahej në paraburgim edhe pas kalimit të 15 ditëve fillestare, përkundër faktit që aktakuza në procedurë të shkurtër ende nuk ishte ngritur kundër tij. Më 2 shkurt 2009, avokati mbrojtës parashtroi një propozim gjykatës që ta ndërpriste paraburgimin e klientit të tij dhe ta zëvendësojë me masën e paraqitjes në stacionin policor; megjithatë, i pandehuri mbeti në paraburgim. Gjatë një seance hetimore të mbajtur më 11 shkurt 2009, avokati mbrojtës përsëri ngriti çështjen e paraburgimit të vazhduar në mënyrë të paligjshme dhe tërhoqi edhe një herë vëmendjen e prokurorit ndaj dispozitave të qarta të nenit 463(2) të KPPPK-së. Pas përfundimit të asaj seance, prokurori i EULEX-it i parashtroi propozim gjykatës për vendosjen e një mase tjetër ndaj të pandehurit; në të njëjtën ditë, gjykatësi i procedurës paraprake i EULEX-it morri vendim për ta ndërprerë paraburgimin e të pandehurit dhe urdhëroi lirimin e tij të menjëhershëm. Në këtë rast, i pandehuri ishte mbajtur në paraburgim për një javë

---

<sup>103</sup> Sipas nenit 5(1) të KEDNj-së, paraburgimi është i ligjshëm vetëm nëse aplikohet në pajtim me kornizën ligjore të Kosovës.

<sup>104</sup> Neni 153 KPPPK.

<sup>105</sup> Neni 278(7) KPPPK. Shih edhe *Vachev kundër Bullgarisë*, Aktgjykimi i GjEDNj-së me datë 8 korrik 2004, paragrafi 64.

<sup>106</sup> Neni 153 KPPK.

<sup>107</sup> Neni 260 KPPK.

më tepër në mënyrë të paligjshme, si dhe ishte liruar vetëm pas propozimeve të përsëritura të avokatit për lirim nga paraburgimi.

Ligji i Kosovës gjithashtu parasheh rregulla më strikte për zbatimin e paraburgimit në rastet me të mitur. Ligji Penal për të Mitur i Kosovës parasheh që paraburgimi i një të mituri nuk mund të jetë më i gjatë se 3 muaj.<sup>108</sup> Megjithatë, është vërejtur në disa raste të izoluara, të miturit mbahen në paraburgim për periudha më të gjata se ajo maksimale prej tre muajsh.

Në një lëndë nga rajoni i Prizrenit në lidhje me një të mitur të dyshuar për veprën e dhunimit,<sup>109</sup> i pandehuri i mitur ishte mbajtur në paraburgim nga arrestimi i tij fillestar më 07 nëntor 2007 deri më 20 mars 2008, duke arritur kështu katër muaj e gjysmë. Paraburgimi i vazhduar i tij pas kalimit të tre muajve fillestarë ishte në kundërshtim të qartë me nenin 64(2) të LPMT-së, si dhe ishte i paligjshëm edhe sipas nenit 5(1) të KEDNj-së.

Në përgjithësi, kohëzgjatja e paraburgimi shpeshherë duket të jetë tepër e gjatë në Kosovë. Disa gjyqtarë të procedurës paraprake urdhërojnë paraburgimin duke i shkelur qartas dispozitat e KPPK-së, derisa në raste tjera paraburgimi zbatohet në përputhje me ligjin vendor të procedurës, por ndoshta pa i vërtetuar bazat tjera “gjegjëse dhe të mjaftueshme” siç kërkohet me standarde ndërkombëtare për ta arsyetuar paraburgimin e zgjatur. Gjyqtarët dhe prokurorët do të duhej t’u përmbahen më me kujdes zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë kohëzgjatjen e paraburgimit gjatë procedurave penale.

## **VII. SHKELJET TJERA NË LIDHJE ME PARABURGIMIN**

Përveç problemeve të lartpërmendura, monitorimi ka zbuluar edhe një numër shkeljesh tjera në lidhje me zbatimin e paraburgimit gjatë procedurave penale të zhvilluara në Kosovë.

Për shembull, të miturit nganjëherë vihen në paraburgim pa kaluar së pari kontrollin e përgjithshëm mjekësor. Kjo gjë është në kundërshtim me kërkesat e qarta të ligjit, i cili thekson që “i mituri i nënshtrohet kontrollit të përgjithshëm mjekësor para fillimit të paraburgimit për t’u siguruar që shëndeti i tij lejon caktimin e paraburgimit.”<sup>110</sup>

Gjithashtu, është vërejtur që disa aktvendime për paraburgim – si aktvendimet për paraburgim fillestar, ashtu edhe aktvendimet për vazhdim të paraburgimit – e tregojnë gabimisht kohën brenda së cilës mund të paraqitet ankesa kundër këtyre aktvendimeve. Për shembull, në to mund të thuhet që ankesa mund të paraqitet brenda tri ditëve, derisa

<sup>108</sup> Neni 64(2), Rregullorja e UNMIK-ut 2004/8 mbi Ligjin Penal për të Mitur të Kosovës, 20 prill 2004; (LPMK).

<sup>109</sup> Neni 193 KPPK.

<sup>110</sup> Neni 42 LPMK.

ligji thotë qartë që ankesa kundër aktvendimit për paraburgim mund të paraqitet brenda njëzet e katër orëve.<sup>111</sup>

Një brengë të veçantë paraqet fakti që gjyqtarët nganjëherë dështojnë ta llogarisin si duhet periudhën e paraburgimit dhe ta përfshijnë atë në dënimin me burgim, duke i shkelur qartas dispozitat e KPPK-së.

Në një lëndë që kishte të bëjë me tre të pandehur të akuzuar për dhënie të ryshfetit<sup>112</sup> dhe një të pandehur (një gjykatës i suspenduar në atë kohë) të akuzuar për marrje të ryshfetit,<sup>113</sup> më 10 korrik 2007, Gjykata Komunale në Prizren nxjerri aktgjykimin përmes së cilit e gjeti një nga të pandehurit fajtor, i liroi dy të pandehurit tjerë, dhe hodhi poshtë aktakuzën kundër të pandehurit të katërt. Të pandehurit që u gjet fajtor për dhënie të ryshfetit iu shqiptua dënimi prej pesë muajsh burgim. Me rastin e dënimit, gjykata urdhëroi që koha që ai e kishte kaluar në paraburgim (gati një muaj i plotë) të zbritet nga periudha pesëmuajshe e dënimit me burg, mirëpo gjykata nuk urdhëroi që periudha që ai e kishte kaluar në arrest shtëpiak pasi që ishte liruar nga paraburgimi (një muaj e gjysmë tjetër) të zbritet në mënyrë të ngjashme nga dënimi.

Mospërfshirja e periudhës së kaluar në arrest shtëpiak (bashkë me periudhën e kaluar në paraburgim) në llogaritjen e dënimit që i pandehuri duhet ta vuajë është një shkelje e qartë dhe e rëndë e dispozitave të Kodit të procedurës penale të Kosovës, që thotë qartë që në llogaritjen e dënimit me burgim duhet të përfshihet jo vetëm periudha e paraburgimit, por edhe çfarëdo periudhe e arrestit shtëpiak.<sup>114</sup> Kështu, jo vetëm koha që një i pandehur e kaloi në paraburgim, por edhe çfarëdo kohe pasuese që ai e kaloi në arrest shtëpiak, duhet të llogaritet në dënimin me burgim (me fjalë tjera, të zbritet nga dënimi). Si diçka që vlen të përmendet, një person, koha e paraburgimit të të cilit nuk është llogaritur në dënimin e shqiptuar për vepër penale, ka të drejtë për kompensim.<sup>115</sup> Prokurorët dhe gjyqtarët e Kosovës do të duhej që gjithmonë ta zbatojnë paraburgimin në pajtim të plotë me dispozitat e zbatueshme ligjore dhe duke pasur konsideratë të plotë ndaj të gjitha mbrojtjeve të garantuara me ligj.

## VIII. SITUATA NË KOMUNAT VERIORE TË RAJONIT TË MITROVICËS

Që nga zhvillimet politike dhe ligjore pas Shkurtit 2008 në Kosovë, sistemi i drejtësisë në rajonin e Mitrovicës në Kosovë ka funksionuar me një kapacitet të kufizuar.<sup>116</sup> Mungesa e

---

<sup>111</sup> Neni 283(3) KPPK.

<sup>112</sup> Neni 344 KPPK.

<sup>113</sup> Neni 343 KPPK.

<sup>114</sup> Neni 278(7)2 i KPPK-së, në lidhje me nenin 73(1) të KPPK-së, parasheh që çfarëdo periudhe e arrestit shtëpiak duhet të përfshihet në dënimin me burgim.

<sup>115</sup> Neni 538(2) KPPK.

<sup>116</sup> Momentalisht nuk ka gjykata funksionale komunale dhe për kundërvajtje në komunën e Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Gjykata e qarkut në Mitrovicë funksionon me kapacitet të kufizuar brenda lokaleve të Gjykatës komunale në Vushtrri; kjo gjykatë e qarkut gjithashtu mbulon komunën e Skenderajt dhe Vushtrrisë, duke i shtuar ato në listën e komunave pa sistem plotësisht funksional të gjykatave. Gjykata



një sistemi plotësisht funksional të drejtësisë dhe prokurorisë e pengon në masë të madhe sundimin e ligjit dhe çon drejt shkeljeve të rënda të së drejtës për liri, së drejtës për qasje në drejtësi dhe së drejtës për proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor.<sup>117</sup> Prej korrikut të vitit 2009, 59 individë janë duke u mbajtur në paraburgim dhe 22 individë në arrest shtëpiak në bazë të aktvendimeve për paraburgim të nxjerra nga Gjykata e qarkut në Mitrovicë dhe Gjykata komunale në Mitrovicë.<sup>118</sup> Shumicës së tyre i është vazhduar vazhdimisht paraburgimi në periudhën gjatë së cilës gjykata ishte duke funksionuar me kapacitet të kufizuar. Rastet në vijim mund të shërbejnë si shembuj:

Në një lëndë para Gjykatës së qarkut në Mitrovicë, një i pandehur i akuzuar për kryerjen e veprës penale të vrasjes së rëndë,<sup>119</sup> tentativës për vrasje,<sup>120</sup> dhe mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve,<sup>121</sup> në bashkëkryerje,<sup>122</sup> është duke u mbajtur në paraburgim prej 6 shkurtit 2007. Gjykimi i tij ishte në fazën përfundimtare në kohën kur gjykata pushoi të funksionojë, në shkurt të vitit 2008, dhe prej atëherë nuk ka pasur zhvillime tjera. Në ndërkohë, gjykata e ka vazhduar vazhdimisht paraburgimin e tij deri në kohën kur është shkruar ky raport.

Në një lëndë tjetër para Gjykatës së qarkut në Mitrovicë, një i pandehur i akuzuar për kryerje të veprës penale të vrasjes<sup>123</sup> dhe mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve<sup>124</sup> është duke u mbajtur në paraburgim prej 31 majit 2007. Gjykimi i tij nuk kishte filluar ende në kohën kur gjykata pushoi të funksionojë. Paraburgimi i tij ishte vazhduar vazhdimisht deri në kohën kur është shkruar ky raport.

Shumë persona tjerë që janë paraburgosur në bazë të aktvendimeve të nxjerra nga Gjykata e qarkut apo Gjykata komunale në Mitrovicë gjenden në një situatë të njëjtë. Kjo situatë sjell deri te brengat serioze sa i përket konsideratës ndaj të drejtave të tyre themelore për

---

komunale në Mitrovicë (që mbulon pjesën jugore dhe veriore të Mitrovicës dhe Zveçanin) gjithashtu vepron me kapacitet të kufizuar në Vushtri. Zyrat e prokurorisë komunale dhe rajonale gjithashtu veprojnë në një shkallë të kufizuar nga ndërtesa e gjykatës në Vushtri dhe nuk janë në gjendje të procedojnë shumicën e krimeve që kanë ndodhur para 21 shkurtit 2008 sepse nuk kanë qasje në shkresat e lëndëve që gjenden në ndërtesën e gjykatës në pjesën veriore të Mitrovicës. Kjo situatë vazhdon prej 21 shkurtit 2008 dhe shpërndarja e gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në dhjetor të vitit 2008 nuk ka sjellë ndonjë përmirësim të dukshëm të saj. Deri më tani, EULEX-i, që vepron nga gjykata që gjendet në pjesën veriore të Mitrovicës, ka mbyllur tri lëndë penale mirëpo, edhe nëse vazhdon me më shumë gjykime në të ardhmen e afërt, çështjet praktike dhe ligjore mund ta parandalojnë atë që ta zëvendësojë në tërësi sistemin gjyqësor të rajonit.

<sup>117</sup> Për më shumë hollësi, shih Raportin mujor të SMSL-së për dhjetor të vitit 2008: Sistemi i drejtësisë në Mitrovicë - Brengat e vazhdueshme për të drejtat e njeriut dhe zhvillimet e fundit.

<sup>118</sup> Informata është marrë nga *Lista e personave që mbahen në paraburgim dhe arrest shtëpiak*, në dispozicion në Gjykatën e qarkut në Mitrovicë dhe Gjykatën komunale në Mitrovicë (korrik, 2009).

<sup>119</sup> Neni 147 KPPK.

<sup>120</sup> Neni 146 dhe 20 KPPK.

<sup>121</sup> Neni 328 KPPK.

<sup>122</sup> Neni 23 KPPK.

<sup>123</sup> Neni 146 i KPPK-së.

<sup>124</sup> Neni 382 i KPPK-së.

liri dhe proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor.<sup>125</sup> Duhet të mbahet mend që çfarëdo periudhe e paraburgimit duhet të shqyrtohet në mënyrë periodike nga ana e gjykatës<sup>126</sup> dhe që organet e zbatimit të ligjit, në rastet e paraburgimeve të zgjatura, kanë për detyrë të tregojnë që baza për paraburgim vazhdon të ekzistojë dhe ta zhvillojnë procedurën me “kujdes të veçantë.”<sup>127</sup> Për më tepër, kurrfarë paraburgimi nuk do të duhej të zgjasë më tepër se që është e nevojshme<sup>128</sup> dhe autoritetet kanë një detyrë të përgjithshme që t’i organizojnë sistemet e tyre ligjore në atë mënyrë që gjykatave t’u mundësohet ta respektojnë të drejtën për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm kohor.<sup>129</sup> Në fund, kur të përballen me moskryerje të përkohshme të punës, autoritetet publike janë të obliguara që, me një urgjencë të nevojshme, të ndërmarrin veprime përmirësuese për t’iu përgjigjur situatës së tillë të jashtëzakonshme.<sup>130</sup>

## IX. PËRFUNDIM

Liria personale është një gjendje qenësore që do të duhej ta gëzojë natyrshëm çdo person dhe çfarëdo kufizimi i saj do të duhej të konsiderohet gjithmonë si masë e fundit, të zbatohet në pajtim të plotë me ligjin dhe të mos zgjasë më shumë se që është e nevojshme. Këto parime kyçe pasqyrohen si në standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ashtu edhe në KPPPK.

Derisa ligji i Kosovës ofron një kornizë adekuate normative që e rregullon zbatimin e paraburgimit gjatë procedurës penale dhe është në masë të madhe në përputhje me standardet e zbatueshme ndërkombëtare, ende mbesin probleme të ndryshme në lidhje me zbatimin e paraburgimit në praktikë. Kërkesat për paraburgim që i parashtrajnë prokurorët dhe aktvendimet mbi paraburgimin që i miratojnë gjyqtarët e procedurës paraprake shpeshherë përmbajnë arsyetim të pamjaftueshëm, paraburgimet nganjëherë zgjasin për një kohë të paarsyeshme të gjatë, si dhe mbesin shumë probleme tjera të mëdha në lidhje me zbatimin e paraburgimit në procedurën e shkurtër. Në komunat veriore të rajonit të Mitrovicës, mungesa e një sistemi gjyqësor plotësisht funksional e pengon në masë të madhe sundimin e ligjit dhe shkakton shkelje të rënda të të drejtave të njeriut.

Në të njëjtën kohë, duhet të thuhet që paraburgimi është një masë procedurale, zbatimi i së cilës rregullohet përmes dispozitave të ndërlukuara ligjore që shpesh herë kërkojnë baraspeshim të kujdesshëm të interesave garues, madje edhe të kundërt. Derisa interesi i autoriteteve është që ta parandalojnë të pandehurin nga ikja, pengimi i drejtësisë apo përsëritja e veprës penale, çfarëdo privimi duhet ta mbizotërojë prezumimin në favor të lirisë. Kosova kurrësi nuk është vendi i vetëm ku masat e paraburgimit shpeshherë

<sup>125</sup> Nenet 5 dhe 6, KEDNj.

<sup>126</sup> Nenet 212(4) dhe 284-287 KPPPK.

<sup>127</sup> Neni 285(1) KPPPK; shih gjithashtu paragrafin 79 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Dobrev kundër Bullgarisë*, të datës 10 gusht 2006.

<sup>128</sup> Neni 5(3) KPPPK; shih gjithashtu paragrafin 152 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Labita kundër Italisë*, të datës 6 prill 2000.

<sup>129</sup> Shih paragrafin 27 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Spentzouris kundër Greqisë*, të datës 7 maj 2002.

<sup>130</sup> Shih paragrafin 23 të aktgjykimit të GjEDNj-së në lëndën *Baggetta kundër Italisë*, të datës 25 qershor 1987.

zbatohen me mangësi në praktikë, përkundër ekzistimit të një kornize adekuate dhe të përshtatshme ligjore. Organet ndërkombëtare monitoruese tregojnë që arrestimet dhe paraburgimet e personave pa ndonjë shkak të arsyeshëm dhe në mungesë të mjeteve efektive juridike në dispozicion të tyre mbeten, fatkeqësisht, një dukuri e përhapur në tërë botën.<sup>131</sup> Në nivel global, Këshilli i KB-ve për të Drejtat e Njeriut rishtas konfirmoi edhe njëherë që “një numër i konsiderueshëm i personave të privuar nga liria e tyre shpesh herë nuk mund të përfitojnë nga resurset dhe garancitë ligjore në të cilat kanë të drejtë për ta përgatitur mbrojtjen e tyre ashtu siç kërkohet me ligj në çfarëdo sistemi ligjor dhe sipas instrumenteve të zbatueshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.”<sup>132</sup> Në nivel rajonal të Evropës, statistikave të GjEDNj-së dëshmojnë që shkeljet e së drejtës për liri dhe siguri në rajonin e Këshillit të Evropës janë në mesin e shkeljeve më të shpeshta të të drejtave të njeriut, duke qenë më të vogla në numër vetëm në krahasim me shkeljet e së drejtës për proces të rregullt dhe së drejtës për pronë.<sup>133</sup>

Gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës do të duhej të angazhohen për t'i përmirësuar mangësitë e identifikuar në zbatimin e masave të paraburgimit duke i respektuar me kujdes të gjitha mbrojtjet ligjore të ofruara në KPPPK. Në krahasim me gjetjet e raportit të fundit të OSBE-së mbi zbatimin e paraburgimit në Kosovë,<sup>134</sup> gjyqtarët dhe prokurorët kanë arritur një përparim gradual gjatë viteve të fundit për të siguruar pajtueshmëri të shtuar me ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut gjatë zbatimit të masave të paraburgimit në procedurat penale. Megjithatë, ende mbesin probleme të konsiderueshme, kurse brengë të veçantë paraqet fakti që ende janë të pranishme shumë shkelje që OSBE-ja i ka identifikuar vite më parë.

## **X. REKOMANDIMET**

### **Për Kuvendin e Kosovës:**

- Ta ndryshojë nenin 14(2) të KPPPK-së në përputhje me nenin 212(4) të KPPPK-së në mënyrë që të shmanget çfarëdo konfuzioni në lidhje me periudhën maksimale sa një i pandehur mund të mbahet në arrest policor para se të dërgohet para një gjyqtari.

### **Për Gjykatën Supreme të Kosovës:**

- Në kontekst të ndonjë lënde specifike apo përmes një mendimi sqarues ligjor, të qartësojë që neni 306(4) i KPPPK-së duhet të lexohet në lidhje me nenet 282 dhe 287(1) të KPPPK-së, dhe që paraburgimi duhet të caktohet gjithmonë vetëm pas seancës së dëgjimit me të pandehurin dhe avokatin mbrojtës të tij, duke përfshirë edhe rastet kur aktakuza përmban propozimin për caktim të paraburgimit.

### **Për policinë:**

---

<sup>131</sup> Shih faqen 161 të “Të drejtat e njeriut në administrimin e drejtësisë. Doracak mbi të drejtat e njeriut për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët (Seria e trajnimit profesional nr. 9).

<sup>132</sup> Paragrafi 45 i *Raportit të Grupit punues për paraburgimin arbitrar* i Këshillit të KB-ve për të Drejtat e Njeriut, A/HRC/10/21 (16 shkurt 2009).

<sup>133</sup> Shih faqet 133 dhe 139 të *Raportit vjetor 2008* të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>134</sup> Shih Raportin e OSBE-së për Kosovë. Shqyrtim i sistemit të drejtësisë penale (prill 2003 – tetor 2004). Krimi, Paraburgimi dhe Dënimi.

- Që gjithmonë të ua dorëzojë kallëzimet penale prokurorëve publik sa më shpejtë që të jetë e mundur në mënyrë që këta të fundit të kenë kohë të mjaftueshme për të përgatitur propozime të arsyetuara si duhet për caktim të paraburgimit, nëse kjo është e nevojshme.

**Për prokurorët:**

- Të propozojnë caktim të paraburgimit vetëm në rastet kur ligji dhe rrethanat specifike të lëndës e arsyetojnë një masë të tillë kufizuese.
- T'i mbështesin gjithmonë propozimet për caktim të paraburgimit me arsye përkatëse dhe të mjaftueshme.

**Për gjyqtarët:**

- Brenda afatit të parashkruar ligjor, të caktojnë dhe mbajnë gjithmonë një seancë të dëgjimit me të pandehurin dhe avokatin mbrojtës të tij para se të vendosin mbi propozimin e prokurorit për caktim të paraburgimit.
- Të ofrojnë arsye përkatëse dhe të mjaftueshme në të gjitha aktvendimet për caktim të paraburgimit, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm ndërkombëtar dhe vendor.
- Të sigurojnë që gjykatat dhe institucionet tjera të përfshira, siç është policia, prokuroria, institutet e mjekësisë ligjore, qendrat për punë sociale etj., të veprojnë me kujdes dhe urgjencë të veçantë në procedurën që ka të bëjë me të pandehur të paraburgosur, si dhe t'u shmangen vonesave të paarsyeshme.

**Për Odën e Avokatëve të Kosovës:**

- T'i udhëzojë avokatët mbrojtës që ta mbrojnë të drejtën e klientëve të tyre për liri përmes argumenteve dhe propozimeve të arsyetuara si duhet.

**Për Institutin Gjyqësor të Kosovës:**

- Të vazhdojë të ofrojë trajnime shtesë për kandidatët për prokurorë dhe gjyqtarë dhe për gjyqtarët dhe prokurorët aktual në lidhje me arsyetimin e duhur të propozimeve për caktim të paraburgimit dhe aktvendimeve që merren mbi to.
- Të vazhdojë të ofrojë trajnime shtesë për gjykatësit dhe prokurorët në lidhje me zbatimin e paraburgimit gjatë procedurës penale në Kosovë.
- T'i ftojë gjithmonë zyrtarët e policisë, të shërbimit sprovues dhe të shërbimit korrektues për të marrë pjesë në trajnime në lidhje me paraburgimin.